

RAPORTI VJETOR

20

AGJENCIA SHQIPTARE E
ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

25

WWW.AIDA.GOV.AL




Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

© Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Materiali i përfshirë në këtë dokument mbrohet nga e drejta e autorit e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Ai mund të kopjohet ose riprodhohet vetëm për qëllime jokomerciale, konkretisht për kërkime, studime private ose për përdorim të kufizuar të brendshëm brenda një organizate, për qëllime studimore dhe analitike. Çdo riprodhim për qëllime jokomerciale duhet të shoqërohet me citim të qartë të burimit, të pasqyrojë me saktësi përmbajtjen origjinale dhe të mos përdoret në një kontekst tjetër nga ai i përcaktuar.

RAPORTI VJETOR



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve



TË JETËSOJMË IDE STRATEGJIKE

Lexues të dashur

Qëllimi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), është të kontribuojë kundrejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet nxitjes, tërheqjes dhe promovimit të të gjitha investimeve vendase dhe të huaja.

Motoja jonë është **TË JETËSOJMË IDE STRATEGJIKE**, duke u shndërruar në partnerin dhe udhërrëfyesin e të gjithë investitorëve të interesuar për të qenë pjesë e rrugëtimit të zhvillimit të tyre dhe atë të Shqipërisë.

Mbështetja jonë kryesore, gjithashtu konsiston në zhvillimin e biznesit shqiptar, për ta bërë atë më konkurrues në tregun vendas dhe në veçanti në tregun e huaj, nëpërmjet zhvillimit të ideve të reja në biznes, si edhe nxitjes së inovacionit.

Ne besojmë fort në vlerat si 'fuqia e diversitetit' dhe 'perspektiva strategjike' duke asistuar dhe mundësuar rritjen e investimeve frytdhënëse për ekonominë e vendit tonë.



Ne e vlerësojmë sinergjinë mes 'udhëtimit' dhe 'destinacionit' dhe nëpërmjet asistencës sonë të specializuar synojmë që nga pika ku ndodhen idetë/projektet dhe subjektet shqiptare e të huaja të arrijnë tek destinacioni, përkthimi i të cilit është një numër i madh investimesh në vend, zgjerimi i biznesit vendas në tregjet e huaja, emri i vetëm i të cilit është

ZHVILLIM I QËNDRUESHËM GJITHËPËRFSHIRËS EKONOMIK.

Le të zgjerojmë artin e së mundurës së bashku, duke u bërë palë në rrugëtimin e zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Laura Faro

Drejtor Ekzekutiv i AIDA



Tabela e PËRMBAJTJES

MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT	01	AIDA DHE PARTNERËT STRATEGJIKË	23
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	02	INVESTIME STRATEGJIKE	26
PROMOVIMI DHE LEHTËSIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA	03	AIDA DHE MEDIA	31
AIDA PJESË E PANAIREVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE	11	TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË AIDA	39
PROMOVIMI I EKSPORTEVE DHE MBËSHTETJA E SME-VE	14	PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM	42
PROJEKTE NË ZBATIM	17		

MISIONI DHE VIZIONI

MISIONI

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), është themeluar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010, “Për themelimin dhe organizimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”.

AIDA është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Fokusi i agjencisë është të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit, promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si edhe promovimin e potencialit turistik të vendit.

Si ndërmjetës mes investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë, AIDA siguron qasje në informacione të përditësuara, siguron një mënyrë efikase të komunikimit me organet qeveritare dhe shërben si një “One-Stop-Shop”, duke mbështetur investitorët gjatë gjithë procesit të investimit.

VIZIONI

Qëllimi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), është të kontribuojë kundrejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet nxitjes, tërheqjes dhe promovimit të të gjitha investimeve vendase dhe të huaja.

Motoja jonë është TË JETËSOJMË IDE STRATEGJIKE, duke u shndërruar në partnerin dhe udhërrëfyesin e të gjithë investitorëve të interesuar për të qenë pjesë e rrugëtimit të zhvillimit të tyre dhe atë të Shqipërisë.

Mbështetja jonë kryesore, gjithashtu konsiston në zhvillimin e biznesit shqiptar, për ta bërë atë më konkurrues në tregun vendas dhe në veçanti në tregun e huaj, nëpërmjet zhvillimit të ideve të reja në biznes, si edhe nxitjes së inovacionit.

Ne e vlerësojmë sinergjinë mes ‘udhëtimit’ dhe ‘destinacionit’ dhe nëpërmjet asistencës sonë të specializuar synojmë që nga pika ku ndodhen idetë/projektet dhe subjektet shqiptare e të huaja të arrijnë tek destinacioni, përkthimi i të cilit është një numër i madh investimesh në vend, zgjerimi i biznesit vendas në tregjet e huaja, emri i vetëm i të cilit është ZHVILLIM I QËNDRUESHËM GJITHËPËRFSHIRËS EKONOMIK.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2025, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) konsolidoi më tej rolin e saj si institucioni kryesor në promovimin e investimeve, mbështetjen e eksporteve dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Veprimtaria e agjencisë u fokusua në forcimin e klimës së investimeve, rritjen e ndërkombëtarizimit të bizneseve shqiptare dhe promovimin e vendit si një destinacion konkurrues për investime strategjike dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Referuar të dhënave të Bankës së Shqipërisë, investimet e huaja direkte vijuan trendin pozitiv edhe gjatë vitit 2025. Për periudhën janar–shtator 2025, fluksi i IHD-ve arriti në rreth 1.21 miliardë euro, niveli më i lartë historik për këtë periudhë, ndërsa stoku i investimeve të huaja direkte u rrit në 16.6 miliardë euro, duke reflektuar besimin në rritje të investitorëve ndërkombëtarë ndaj ekonomisë shqiptare. Sektorët kryesorë që kontribuan në këtë rritje ishin pasuritë e paluajtshme, energjia, aktivitetet financiare, industria nxjerrëse dhe tregtia.

Në kuadër të promovimit dhe lehtësimit të investimeve, AIDA intensifikoi aktivitetin e saj në gjenerimin e leads dhe shërbimet aftercare për investitorët ekzistues dhe potencialë. Gjatë vitit 2025 u asistuan kompani të rëndësishme ndërkombëtare në sektorë prioritarë si ICT/BPO, fintech, manifaktura dhe pajisjet mjekësore. Njëkohësisht, AIDA zhvilloi fushata të dedikuara outreach në tregje strategjike dhe organizoi nismën “Investor Support Days”, duke forcuar dialogun institucional me investitorët dhe adresimin e problematikave të tyre në koordinim me institucionet publike.

Një nga momentet më të rëndësishme të vitit ishte organizimi për herë të parë i forumit ndërkombëtar “Match-Maker Albania 2025”, i cili mblodhi mbi 1,000 pjesëmarrës nga 37 shtete, më shumë se 500 investitorë të huaj dhe dhjetëra kompani eksportuese shqiptare. Ky event shërbeu si platforma më e madhe kombëtare për krijimin e partneriteteve B2B, B2G dhe G2G, duke promovuar konkretisht projektet strategjike dhe potencialin investues të Shqipërisë.

Paralelisht, AIDA organizoi dhe bashkëorganizoi një sërë forumesh ekonomike ndërkombëtare dhe aktivitete promovuese me partnerë strategjikë nga Franca, Turqia, Egjipti, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimi Evropian. Gjithashtu, agjencia mori pjesë në panairë prestigjioze ndërkombëtare si ITB Berlin, MIPIIM Cannes, VivaTech Paris, BIOFACH, Wine Paris dhe Food Expo Athens, duke promovuar sektorët prioritarë të ekonomisë shqiptare dhe produktet “Made in Albania”.

Në mbështetje të zhvillimit të NVM-ve, AIDA menaxhoi Fondin për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme me një vlerë totale prej rreth 131.8 milionë lekësh. Nga ky fond përfituan 85 kompani në kuadër të skemave për konkurrueshmëri, teknologji, artizanat dhe ndërkombëtarizim. Krahas mbështetjes financiare, AIDA organizoi sesione informuese, trajnime dhe aktivitete ndërgjegjësuese për rritjen e kapaciteteve eksportuese të bizneseve shqiptare.

Një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit ishte avancimi i Platformës së Eksporteve “Export Albania”, e konceptuar si një instrument strategjik për ndërkombëtarizimin e bizneseve shqiptare. Platforma mundësoi regjistrimin dhe promovimin e kompanive eksportuese, si dhe aksesin në instrumente inteligjence tregu dhe rrjetëzimi ndërkombëtar. Gjithashtu, platforma “Akses në Financë” vijoi të luajë një rol kyç në informimin e bizneseve mbi grantet dhe instrumentet financiare vendase dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të programit Enterprise Europe Network (EEN Albania), AIDA dhe partnerët e konsorciumit realizuan rezultate të rëndësishme në mbështetjen e ndërmarrjeve shqiptare drejt inovacionit, digjitalizimit dhe aksesit në tregjet europiane. Gjatë ciklit 2022–2025 u asistuan mbi 1,456 NVM dhe u realizuan 27 marrëveshje konkrete partneriteti ndërkombëtar, duke tejkaluar ndjeshëm targetet e vendosura.

Në fushën e investimeve strategjike, AIDA vijoi të ushtrojë funksionin e saj si One Stop Shop dhe Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike. Gjatë vitit 2025 u trajtuan 7 projekte strategjike, nga të cilat 6 u miratuan, kryesisht në sektorët e turizmit dhe energjisë. Paralelisht, u monitoruan 22 projekte strategjike në zbatim, duke evidentuar nevojën për forcimin e koordinimit institucional dhe përsheptimin e procedurave administrative.

Në aspektin institucional dhe të komunikimit publik, AIDA forcoi ndjeshëm praninë e saj mediatike dhe digjitale. Përmes një strategjie të integruar komunikimi, agjencia promovoi investimet, eksportet, sektorët strategjikë dhe historitë e suksesit të bizneseve shqiptare, duke arritur rritje të konsiderueshme të angazhimit në rrjetet sociale dhe të dukshmërisë institucionale.

Në tërësi, viti 2025 përfaqëson një vit konsolidimi institucional dhe zgjerimi të rolit të AIDA-s në zhvillimin ekonomik të vendit. Përmes promovimit aktiv të investimeve, mbështetjes së eksporteve, fuqizimit të NVM-ve dhe forcimit të partneriteteve strategjike, AIDA kontribuoi në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare dhe në avancimin e integritit të saj në tregjet rajonale dhe europiane.

PROMOVIMI DHE LEHTËSIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI


FLUKSI 2025

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, trendi i IHD-ve në terma të fluksit, vijon si më poshtë:

VITI	2020	2021	2022	2023	2024	2025
FLUKSI (mln EURO)	937	1,033	1,372	1,499	1,580	1,635

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga AIDA

Për vitin 2025, fluksi shënon vlerën afro € 1,64 miliardë, niveli më i lartë historik për këtë indikator. Krahasuar me vitin 2024, vihet re një rritje me € 55 milionë, duke konfirmuar vazhdimësinë e besimit të investitorëve dhe konsolidimin e Shqipërisë si një destinacion konkurrues për investime



Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga AIDA

FLUKSI SIPAS SHTETEVE^[1]

Për vitin 2025, fluksi i investimeve të huaja direkte në vend është kryesuar nga Holanda, e cila ka përfaqësuar rreth 12.3% të totalit. Në vijim renditen Italia me 11.4%, Kosova me 11.3%, si dhe Turqia dhe Austria me përkatësisht 11% dhe 9% të fluksit total të investimeve.

Anash gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për vitin 2025 sipas shteteve kryesore:

SHTETI	FLUKSI 2025 (mln EUR)
Holandë	202
Itali	187
Kosovë	186
Turqi	181
Austri	146

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga AIDA

FLUKSI SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Për vitin 2025, burimi kryesor i hyrjeve të fluksit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) ka qenë Sektori i aktiviteteve të pasurive të paluajtshme, i cili ka përfaqësuar 34.3% të totalit.

Kontribute të rëndësishme në flukset e IHD-ve kanë dhënë gjithashtu:

- Aktivitetet financiare dhe të sigurimit – 17.8%,
- Tregtia me shumicë dhe pakicë – 9.9%.
- Industria nxjerrëse – 9.8%,
- Energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë – 8%.

Anash gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për vitin 2025 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

AKTIVITETI EKONOMIK	VLERA E FLUKSIT (mln EURO)
<i>Aktivite të pasurive të paluajtshme</i>	561
<i>Aktivite financiare dhe të sigurimit</i>	291
<i>Industria nxjerrëse</i>	162
<i>Tregtia me shumicë dhe pakicë</i>	161
<i>Energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë</i>	132

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga AIDA

[1] 302 milionë Euro i përkasin ‘Të tjera për arsye konfidencialiteti’.


STOKU 2025

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, trendi i investimeve të huaja direkte (IHD) në terma të stokut, vijon si më poshtë:

VITI	2020	2021	2022	2023	2024	2025
STOKU (mln EURO)	8,482	9,283	11,064	13,261	15,414	16,995

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga AIDA

Në fund të vitit 2025, indikator i stokut shënon vlerën rreth € 17 miliardë, duke shënuar shifër rekord në stokun e investimeve të huaja direkte në vend. Krahasuar me fundin e vitit 2024, treguesi i stokut ka pësuar një rritje me afro 1.6 miliardë Euro ose 10.2%.



Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga AIDA

STOKU SIPAS SHTETEVE

Në fund të vitit 2025, stoku i investimeve të huaja në vend është dominuar nga Holanda e cila ka kontribuar me rreth 16.2% në stokun total, e ndjekur nga Zvicra me 13.8%, Kanadaja me 12.1%, Italia me 11.1% dhe Turqia me 8.2%.

Anash gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut në fund të vitit 2025 sipas shteteve kryesore:

SHTETI	VLERA E STOKUT SHTATOR 2025
<i>Hollandë</i>	2,761
<i>Zvicër</i>	2,348
<i>Kanada</i>	2,059
<i>Itali</i>	1,893
<i>Turqi</i>	1,407

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga AIDA

STOKU SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Në fund të vitit 2025, burimi kryesor i hyrjeve të stokut të IHD-ve ishte Energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë që përfaqësonte afro 22.6% të stokut total. Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë në IHD në terma të stokut janë sektori i Industrisë nxjerrëse me 16%, Aktiviteteve të pasurive të paluajtshme me 15.5%, i Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me 11.2%, i Informacionit dhe Komunikacionit me 9.4% dhe i Industrisë përpunuese me 9.1% ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut në fund të vitit 2025 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

AKTIVITETI EKONOMIK	VLERA E STOKUT SHTATOR 2025 (mln EURO)
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	3,843
Industria nxjerrëse	2,722
Aktivitete të pasurive të paluajtshme	2,633
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	1,913
Informacioni dhe komunikacioni	1,595
Industria përpunuese	1,547

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga AIDA

GJENERIMI I LEADS

AIDA vazhdon të luajë një rol kyç në mbështetjen dhe orientimin e investitorëve të huaj dhe vendas, duke ofruar asistencë të vazhdueshme për kompanitë e interesuara që synojnë të investojnë në Shqipëri. Nëpërmjet një qasjeje proaktive, AIDA u mundëson investitorëve informacion të përditësuar dhe të detajuar mbi klimën e biznesit në vend, sistemin fiskal dhe doganor, kuadrin ligjor për investimet, lehtësirat dhe incentivat fiskale që ofrohen për investitorët e huaj, si dhe mundësitë për krijimin e partneriteteve me biznese vendase në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Gjatë vitit 2025, AIDA ka ndjekur dhe asistuar nga afër 9 kompani ndërkombëtare të rëndësishme, të cilat kanë shprehur interes për të investuar në Shqipëri: Cetwell, Secitops, Skroutz, Berkely Health, Metalolgalva, Grand Impero, dhe Feliolli.

Për të gjitha këto kompani, AIDA ka ofruar shërbime të personalizuar dhe asistencë të drejtpërdrejtë, përfshirë:

- Akses në informacione të detajuara mbi tregun shqiptar dhe sektorët potencialë për investim;
- Përmirësimin e komunikimit ndërinstitucional me organet përkatëse qeveritare, për të lehtësuar proceset administrative dhe koordinimin institucional;
- Identifikimin aktiv të opsioneve të përshtatshme të pronave që përmbushin kërkesat e kompanive të interesuara;

ZHVILLIMI I FUSHATAVE PROMOVUESE PËR TËRHEQJEN E INVESTIMEVE

Gjatë vitit 2025, AIDA organizoi dy fushata outreach për tërheqjen e investimeve të huaja, të fokusuar në sektorët ICT/BPO dhe manifakturën e pajisjeve mjekësore.

- Në kuadër të fushatës outreach në sektorin ICT/BPO, AIDA, në bashkëpunim me ABSL Albania, zhvilloi një takim me përfaqësuesin e kompanisë Secitops, me qëllim eksplorimin e interesit për investim në Shqipëri në fushën e fintech, financës digjitale dhe shërbimeve të biznesit.

Gjatë diskutimeve, kompania prezantoi interesin për krijimin e një platforme digjitale dhe hapjen e një banke online, të fokusuar në transfertat ndërkombëtare të parave dhe ofrimin e shërbimeve financiare për sektorin ICT dhe outsourcing, duke e konsideruar Shqipërinë si një treg potencial për zgjerim të operacioneve të saj. Gjatë takimit, AIDA prezantoi potencialin e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime në ICT/BPO, duke vënë në pah fuqinë punëtore të kualifikuar, kostot konkurruese, si dhe pozicionin strategjik të vendit në raport me tregjet e Bashkimit Evropian. Në vijim, AIDA do të mbajë komunikim të vazhdueshëm me kompaninë dhe do të koordinohet me institucionet përkatëse financiare dhe rregullatore për të vlerësuar më tej realizueshmërinë dhe hapat konkretë për zhvillimin e këtij projekti në Shqipëri.

- Fushata e dytë, me fokus manifakturën e pajisjeve mjekësore, u organizua me mbështetjen e Regional Cooperation Council (RCC) dhe u zhvillua në Düsseldorf, më 16–17 nëntor 2025, në kuadër të panairit ndërkombëtar MEDICA/COMPAMED 2025.

Pjesëmarrja në këtë panair krijoi mundësinë të ndërveprojmë drejtpërdrejt me kompani të fushës, të prezantojmë potencialin e Shqipërisë dhe të forcojmë pozicionimin tonë si destinacion i favorshëm për investime në këtë industri në rritje. Gjatë dy ditëve të takimit, u zhvilluan rreth 15 takime.

Gjatë takimeve, u vu re fakti se një numër i konsiderueshëm kompanish tashmë kanë partneritete me kompani që operojnë në Shqipëri, çka paraqet një mundësi reale për të çuar më tej marrëdhëniet ekzistuese dhe për të ndërtuar bazën për investime të reja direkte.

Në të dyja ditët e fushatës, AIDA pati mundësinë të përçojë një mesazh të qartë dhe të strukturuar mbi përparësitë që ofron vendi ynë për investorët e huaj: stabilitetin makroekonomik, një klimë të favorshme biznesi, kostot konkurruese, akses të shpejtë drejt tregjeve të BE-së dhe rajonit, si dhe përqendrimin në zhvillimin e sektorëve me vlerë të shtuar.

Fushata outreach u përmyll me sukses, duke konsoliduar kontakte të rëndësishme dhe duke rritur interesin për Shqipërinë si një destinacion konkurrues për investime në sektorin e prodhimit të pajisjeve mjekësore. AIDA nisi një proces të strukturuar follow-up-i me të gjitha kompanitë e takuara. Gjatë muajit dhjetor u organizuan dy takime online me kompanitë Barkeley Health dhe Moslab.

PLANI I VEPRIMIT AFTERCARE

Gjatë vitit 2025, Sektori Lead & Aftercare pranë Drejtorisë së Investimeve të Huaja, Partneritetit dhe Kërkimit në AIDA organizoi 1 fushatë të shërbimit të përkujdesjes ndaj investorit, dhe 1 tryezë të rrumbullakët me kompani të sektorit të ICT-BPO dhe teknologjisë së informacionit dhe ndërmori nismën “Investor Support Days”. Rrjeti i bashkëpunimit me qeverisjen lokale funksionon aktualisht me 12 bashki të vendit, përkatësisht Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier, Elbasan, Kavajë, Vorë, Kamëz dhe bashkinë Korçë.

Në kuadër të zhvillimit të forumit më të madh të investimeve Match-Maker Albania, i cili u mbajt për herë të parë në muajin Mars, u realizuan 29 takime me subjekte të huaj dhe vendas, duke i asistuar gjatë eventit me ndërlidhje kontaktesh dhe bashkëpunimesh me palët relevante, kompani, institucione shtetërore, ambasada, agjenci homologe investimesh etj.

Në muajt Prill–Maj u zhvillua fushata Aftercare me kompani të sektorit ICT-BPO, në bashkëpunim me Shoqatën ABSL Albania, gjatë së cilës u realizuan takime me 11 kompani. Në këtë kuadër u organizua gjithashtu Tryeza e Rrumbullakët e Sektorit ICT-BPO, me pjesëmarrjen e 18 kompanive nga sektori.

Me bashkëpunimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit AIDA finalizoi me sukses nismën "Investor Support Days". Kjo iniciativë u zhvillua përmes takimeve javore me kompanitë zvicerane, britanike dhe amerikane. AIDA pati përfaqësinë e institucioneve si Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj. Gjithashtu ambasadat e Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar si dhe SWISSA-s, Dhomës Britanike të Tregtisë dhe AmCham.

Në këto tryeza morën pjesë një total prej 54 kompanish. Në vijim të problematikave të raportuara janë dërguar dhe po ndiqen me prioritet shkresat dhe korrespondenca elektronike me institucionet e qeverisjes qendrore për kompanitë.

Në total, përgjatë vitit 2025, AIDA ka takuar 112 kompani përmes vizitave në terren, tryezave të rrumbullakëta, si edhe përmes iniciativave të tjera të ndërmarra në kuadër të angazhimit të saj me kompanitë e huaja dhe vendase.

MATCHMAKER ALBANIA

Në muajin Mars 2025, për herë të parë, AIDA organizoi eventin Match Maker Albania, një nga ngjarjet më të rëndësishme për nxitjen e investimeve dhe bashkëpunimit ekonomik në Shqipëri. Kjo platformë unike synon të lidhë investitorë të huaj me mundësi konkrete në tregun shqiptar, duke ofruar hapësira për takime direkte B2B (biznes me biznes), B2G (biznes me qeveri) dhe G2G (qeveri me qeveri).

Fakte kryesore të eventit:

- Të pranishëm përfaqësues nga 37 shtete, duke reflektuar interesin e gjerë ndërkombëtar.
- Mbi 500 investitorë të huaj morën pjesë për të eksploruar mundësitë që ofron Shqipëria.
- Eventu mbledhi më shumë se 1000 pjesëmarrës, përfshirë sipërmarrës, diplomatë, përfaqësues institucionesh dhe media.
- U prezantuan 30 kompani eksportuese shqiptare, të cilat ofruan partneritete të mundshme për tregjet ndërkombëtare.
- 30 projekte konkrete investimi, kryesisht në sektorin e turizmit dhe real estate.
- 10 institucione publike dhe mbështetëse ishin të pranishme me info desk për të ofruar informacion dhe asistencë për investitorët.

FORUME EKONOMIKE

Gjatë vitit 2025, AIDA ka qenë organizatorë/bashkëorganizatore e shumë forumeve ekonomike me qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik. Në vijim janë forumet ekonomike:

- **Forumi i Biznesit Shqipëri–Francë**

Në muajin Mars AIDA, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Shqipëri, organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri–Francë, me pjesëmarrjen e një delegacioni të nivelit të lartë nga MEDEF International, i kryesuar nga Z. Christophe Petit. Forumi shërbeu si një platformë e rëndësishme dialogu për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e investimeve franceze në Shqipëri.

Gjatë eventit u theksua interesi i kompanive franceze për bashkëpunime dhe investime në Shqipëri, në një kontekst ku Franca renditet ndër shtatë kontribuesit kryesorë të Investimeve të Huaja Direkte në vend. Paneli i diskutimit mbledhi përfaqësues të lartë të institucioneve shqiptare dhe të sektorit të zhvillimit ekonomik, të cilët prezantuan politikat mbështetëse, projektet strategjike dhe potencialet e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime.

Forumit u pasua nga takime B2B mes bizneseve shqiptare dhe franceze, duke krijuar mundësi konkrete për partneritete të reja dhe bashkëpunim afatgjatë mes dy vendeve.

- **Forumi ekonomik WB6 – EU**

Më datë 13–14 tetor, në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, u zhvillua Forumi i Investimeve EU–WB6, një ngjarje dyditore me rëndësi strategjike, e fokusuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të promovimit të investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe në nxitjen e investimeve të huaja direkte në rajon. Forumi mbledhi përfaqësues të nivelit të lartë nga vendet e rajonit, Bashkimi Evropian dhe institucione kyçe ndërkombëtare, përfshirë edhe Presidenten e Komisionit Evropian, znj. Ursula von der Leyen, duke shërbyer si një platformë për dialog, koordinim dhe shkëmbim praktikash më të mira.

Në kuadër të forumit, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, firmosi disa Deklarata të Përbashkëta Bashkëpunimi, me synimin për të forcuar marrëdhëniet ekonomike ndërrajonale dhe për të promovuar Ballkanin Perëndimor si një destinacion të unifikuar dhe konkurrues për investime.

- **Side event “IPAs connect”**

Në kuadër të Forumit Ekonomik WB6–BE, AIDA organizoi aktivitetin paralel “IPAs Connect”, i cili bashkoi përfaqësues nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Bashkimi Evropian, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), si dhe Banka Botërore.

Në këtë aktivitet morën pjesë agjencitë e investimeve të Shqipërisë (AIDA), Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, duke krijuar një platformë të strukturuar dialogu dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.

Aktiviteti mbledhi së bashku aktorë kyç nga Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian, duke shërbyer si një hapësirë për shkëmbimin e përvojave, praktikave më të mira dhe mundësitë të investimit në rajon. Pjesëmarrja e përfaqësuesve kontribuoi në pasurimin e diskutimeve, në ndarjen e informacionit mbi tregjet kombëtare përkatëse, si dhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e promovimit dhe lehtësimit të investimeve.

Gjithashtu, përfaqësues nga Gjermania, Franca, Italia, Hungaria, si dhe vende të tjera evropiane, prezantuan praktika të suksesshme në promovimin e investimeve, duke theksuar potencialin e Ballkanit Perëndimor si një destinacion konkurrues dhe në rritje për investimet e huaja direkte.

- **Forumi ekonomik Shqipëri – Turqi**

Më datë 17 tetor u zhvillua Forumi më i Madh i Investimeve Shqipëri – Turqi 2025, një ngjarje e rëndësishme e organizuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në bashkëpunim me MËSIAD Albania.

Forumit shërbeu si një platformë e nivelit të lartë për të forcuar bashkëpunimin ekonomik, për të rritur shkëmbimet tregtare dhe për të identifikuar mundësi të reja investimi midis dy vendeve. Forumit mbledhi përfaqësues të qeverive, investitorë, sipërmarrës, organizata biznesi dhe stakeholderë të rëndësishëm nga Shqipëria dhe Turqia.

Në kuadër të Forumit u zhvilluan edhe katër panele tematike, të cilat adresuan sektorët kryesorë strategjikë të zhvillimit ekonomik dhe investimeve, me tematika:

- Paneli I: “Turizmi i së Nesërmes: Investime për një Destinacion Elitar”,
- Paneli II: “Zhvillimi Strategjik i Infrastrukturës dhe Ndërtimit”,
- Paneli III: “Bujqësia në Fokus: Rritja e Investimeve dhe Zhvillimi i Sektorit”, si dhe
- Paneli IV: “E Ardhmja Digjitale e Shqipërisë: Inovacioni dhe Potenciali i Investimeve”.

Paneistët ofruan diskutime të thelluara mbi mundësitë konkrete të bashkëpunimit dhe investimeve mes Shqipërisë dhe Turqisë.

Forum i Investimeve Shqipëri–Turqi 2025 shënon hapjen e një kapitulli të ri në partneritetin strategjik midis dy vendeve dhe krijon bazat për një zhvillim të qëndrueshëm, rritje të investimeve dhe forcim të marrëdhënieve tregtare në vitet që vijnë.

• **Tirana Economic Forum**

Më 10 Dhjetor, në kuadër të Tirana Economic Forum, liderë politikë, përfaqësues të biznesit dhe akademikë u mbledhën për të diskutuar sfidat dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe rajonit. Forumi shërbeu si një platformë e rëndësishme dialogu mbi politikat ekonomike, klimën e investimeve dhe bashkëpunimin rajonal.

Një nga sesionet kryesore të forumit ishte paneli “Albania’s Investment Pulse: How Can Albania Attract Quality Investment”, i cili u fokusua në strategjitë për tërheqjen e investimeve cilësore dhe drejtimet strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit.

Në këtë panel morën pjesë përfaqësues nga sektori publik, biznesi dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ishte e përfaqësuar në këtë panel, duke kontribuar në diskutimet mbi përmirësimin e klimës së investimeve, rolin e reformave, infrastrukturës dhe partneriteteve në rritjen e konkurrueshmërisë së Shqipërisë si destinacion investimesh.

• **Forumi ekonomik Shqipëri – Egjipt**

Në datat 12–14 dhjetor 2025, në Tiranë u zhvillua Forumi i Biznesit Shqipëri–Egjipt, i cili mbledhi përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet publike dhe komuniteti i biznesit të të dy vendeve, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e partneriteteve strategjike. Forumi u zhvillua me pjesëmarrjen e ministres së Ekonomisë dhe Inovacionit të Shqipërisë, znj. Delina Ibrahimaj, dhe ministres së Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës Arabe të Egjiptit, Dr. Rania Al-Mashat

Diskutimet u fokusuan në rritjen e shkëmbimeve tregtare, nxitjen e investimeve të ndërsjella dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në sektorë strategjikë si energjia, turizmi, bujqësia, teknologjia dhe punësimi. Një nga rezultatet më të rëndësishme të forumit ishte nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Autoritetit të Përgjithshëm për Investime dhe Zonat e Lira të Republikës Arabe të Egjiptit (GAFI) dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), i cili synon thellimin e bashkëpunimit në fushën e investimeve dhe përmirësimin e klimës së biznesit.

Forum shërbeu si një platformë kyçe për forcimin e dialogut institucional dhe ekonomik mes Shqipërisë dhe Egjiptit, duke krijuar baza të qëndrueshme për bashkëpunim afatgjatë dhe iniciativa konkrete zhvillimi.

INTELIGJENCA E TREGUT PËR IHD

Me qëllim rritjen e kapaciteteve analitike dhe përmirësimin e procesit të identifikimit dhe targetimit të investitorëve të huaj, që prej shtatorit 2025 AIDA është abonuar në platformën FDI Market. Kjo platformë ofron informacion të strukturuar dhe të përditësuar mbi flukset globale të IHD-ve, projektet greenfield, sektorët prioritarë dhe vendimmarrjen e investitorëve ndërkombëtarë.

Përdorimi i këtij instrumenti analitik ka forcuar bazën informative për mbështetjen e vendimmarrjes strategjike, orientimin e prioriteteve sektoriale dhe planifikimin e aktiviteteve të promovimit dhe tërheqjes së investimeve në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit.

AIDA PJESË E PANAIREVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Pjesëmarrja e kompanive shqiptare në panairët ndërkombëtarë shërben si një instrument kyç për promovimin e produkteve dhe shërbimeve “Made in Albania” në tregjet globale, duke rritur dukshmërinë e tyre dhe besueshmërinë përballë blerësve, distributorëve dhe partnerëve të huaj. Përmes këtyre panairove, bizneset krijojnë kontakte B2B, eksplorojnë tregje të reja, kuptojnë trendet ndërkombëtare të sektorit dhe përshtatin ofertën e tyre sipas kërkesave të tregut. Gjithashtu, pjesëmarrja ndihmon në rritjen e eksporteve, përmirësimin e standardeve të cilësisë dhe certifikimit, si dhe në ndërtimin e një imazhi pozitiv për ekonominë shqiptare në arenën ndërkombëtare, duke kontribuar drejtpërdrejt në konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sipërmarrjeve vendase.

- **“Wine Paris”, në datat 10-12 shkurt 2025, Paris, Francë**

Në datat 10-12 shkurt 2025, AIDA u përfaqësua për herë të parë me stendë në panairin “Wine Paris”, Francë. Synimi i pjesëmarrjes në këtë panair ishte rritja dhe zhvillimi i konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare, nëpërmjet ndërkombëtarizimit dhe promovimit të kompanive që eksportojnë, mundësimin e takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet (B2B) dhe mbështetjen e kompanive shqiptare me logjistikë për takimet e planifikuara, rritjen e nivelit të eksporteve, si dhe gjetjen e tregjeve të reja. Në këtë panair morën pjesë 3 kompani të sektorit të verës dhe u realizuan 20 kontakte me kompani të huaja.

- **“Biofach 2025”, datat 11-14 Shkurt 2025, Nuremberg, Gjermani**

Në datat 11-14 shkurt 2025, AIDA së bashku me SIPPO Albania dhe ITC, organizuan dhe ishin me stendë shqiptare për të katërtën herë në panairin BIOFACH në Nuremberg, Gjermani. Synimi i pjesëmarrjes në këtë panair ishte rritja dhe zhvillimi i konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare si bimët mjekësore dhe aromatike dhe vaji i ullirit nëpërmjet ndërkombëtarizimit dhe promovimit të kompanive që eksportojnë, mundësimin e takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet (B2B) dhe mbështetjen e kompanive shqiptare me logjistikë për takimet e planifikuara, rritjen e nivelit të eksporteve, si dhe gjetjen e tregjeve të reja. Në këtë panair morën pjesë 8 kompani, 6 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 2 kompani nga sektori i vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 467 kontakte me kompani të huaja.

- **Panairi i Punës, Athinë, Greqi.**

Më 2 mars 2025, AIDA mori pjesë në Panairin “Puno & Jeto Aty Ku Ke Zembrën”, i cili u mbajt në Athinë, Greqi. Panairi kishte si qëllim informimin dhe ofrimin e mundësive të reja për punësim, investim dhe kthimin në Shqipëri të shqipëtareve që jetojnë dhe punojnë në Greqi, për të kontribuar në zhvillimin e vendit. Synimi i pjesëmarrjes në këtë panair ishte tërheqja e investimeve nga diaspora dhe informimi mbi mundësitë për zhvillimin e biznesit në Shqipëri.

Në panair morën pjesë kompani të ndryshme shqiptare që operojnë në sektorë si bujqësia, ndërtimi, turizmi dhe teknologjia, etj. Përpos subjekteve private, pjesë e panairit ishin dhe institucionet shtetërore si: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Korporata Shqiptare e Investimeve (AIC), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), etj.

- **ITB Berlin, Berlin, Gjermani**

Në datat 4-6 mars 2025, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, mori pjesë si bashkë-ekspozuese krahas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në panairin ITB Berlin.

ITB Berlin (Internationale Tourismus-Börse Berlin) është panairi më i madh i turizmit në botë, i cili tërheq shumë ekspozues dhe pjesëmarrës dhe mbetet një platformë kyç për rrjetëzimin, inovacionin dhe turizmin global. Gjithashtu luan një rol jetik në formësimin e trendeve, politikave dhe partneriteteve në sektorin e turizmit. Kompanitë e përfaqësuara në panair përfshijnë hotele, struktura akomoduese, operatorë turistikë, linja ajrore etj.

Shqipëria në këtë panair kishte vendin e nderit si Host Country dhe AIDA mernte pjesë në rolin e institucionit përgjegjës për tërheqjen e IHD-ve në sektorin e turizmit si një ndër sektorët prioritarë dhe strategjikë në zhvillimin e vendit. Përmes pjesëmarrjes synohej dhe prezantimi i paketave më të reja incentivuese në sektor. Gjithashtu dhe koordinimi i takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet dhe mbështetja e kompanive shqiptare për takimet e planifikuara.

- **“Food Expo”, në datat 8-10 mars 2025, në Athinë.**

Në datat 8-10 mars 2025, u zhvillua panairi ndërkombëtar “Food Expo” në Athinë, Greqi. Shqipëria u përfaqësua për herë të dytë në këtë panair me stendë të organizuar nga AIDA. Në këtë panair morrën pjesë 6 kompani, 2 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 3 kompani nga sektori i verës dhe një kompani nga sektori i prodhimit të kafes. Kompanitë realizuan 209 kontakte me kompani të huaja.

- **MIPIM, Kanë, Francë.**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në përmbushje të funksionit të saj si institucioni kyç për tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri dhe promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh, mori pjesë në panairin MIPIM 2025, gjatë datave 11 – 14 Mars 2025. MIPIM (Marché International des Professionnels de l'Immobilier) është event i madh dhe më prestigjioz në botë për industrinë e real estate, i cili mbahet çdo vit në qytetin e Kanës, Francë.

AIDA zhvilloi një sërë takimesh me investitorë dhe operatorë ndërkombëtarë të sektorit, duke shkëmbyer informacione mbi potencialet dhe avantazhet konkurruese të Shqipërisë.

Gjatë panairit, AIDA nënshkroi një Marrëveshje me Miami Association of Realtors, shoqata më e madhe e profesionistëve të pasurive të paluajtshme në SHBA.

- **VivaTech, Paris, Francë**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), mori pjesë për herë të parë në panairin ndërkombëtar të teknologjisë dhe inovacionit VivaTech 2025, i zhvilluar në Paris më 11-14 qershor 2025. Në stendën e përbashkët të Shqipërisë, nën moton “Albania Future Now”, u promovuan mundësitë e vendit në sektorin ICT/BPO dhe ekosistemin e inovacionit, duke u realizuar dhjetëra takime me kompani ndërkombëtare të profil të lartë si IBM, Amazon, Eviden, inetum, etj. Fushata outreach e ndërmarrë nga AIDA gjatë këtij eventi rezultoi e suksesshme, duke gjeneruar interes konkret nga investitorë potencialë dhe partnerë ndërkombëtarë, si dhe duke hapur rrugën për bashkëpunime të reja strategjike në fushën e teknologjisë dhe shërbimeve të biznesit.

- **Expo 40/40, Tiranë**

AIDA mori pjesë në Expo 40/40, të organizuar nga BLOCONOMY, duke qenë pjesë e një paneli para anëtarëve pjesëmarrës. Në këtë aktivitet u prezantuan mundësitë që AIDA ofron për bizneset shqiptare dhe rajonale, duke përfshirë takime B2B, pjesëmarrjen në panair kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe mundësitë për mbështetje financiare në zhvillim dhe zgjerim. Forumi shërbeu si një hapësirë e rëndësishme për sipërmarrësit në krijimin e partneriteteve dhe zgjerimin e bashkëpunimeve të reja.

- **Panairi “Riga Food 2025”, në datat 04-06 shtator, në Letoni.**

Në datat 04-06 shtator 2025, AIDA së bashku me SIPPO Albania, organizuan dhe ishin me stendë shqiptare për herë të parë panairin “Riga Food 2025”, në Letoni. Synimi i pjesëmarrjes në këtë panair ishte rritja dhe zhvillimi i konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare nëpërmjet ndërkombëtarizimit dhe promovimit të kompanive që eksportojnë, mundësimin e takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet (B2B) si dhe gjetjen e tregjeve të reja. Në këtë panair morën pjesë 6 kompani, 1 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 1 kompani nga sektori i mjaltit, 1 kompani nga sektori i ullinjve dhe i vajit të ullirit, 1 kompani nga sektori i prodhimit të luleshtrydheve, 1 kompani nga sektori i përpunimit të domateve, dhe një nga sektori i përbërësve ushqimor. Kompanitë realizuan 199 kontakte me kompani të huaja.

- **Panairi “A+A 2025”, në datat 4-7 Nëntor 2025 Düsseldorf, Gjermani,**

Në datat 04-07 nëntor 2025, AIDA së bashku me SIPPO Albania, organizuan dhe ishin me stendë shqiptare për herë të parë panairin “A+A 2025”, Düsseldorf, Gjermani, Në këtë panair morën pjesë 5 kompani të sektorit të rrobave të punës. Kompanitë realizuan 280 kontakte me kompani të huaja. Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar A+A 2025 hapi mundësi reale për rritjen e eksporteve dhe përfshirjen e prodhuesve shqiptarë në zinxhirët e furnizimit ndërkombëtar.

- **Natural Organic Dubai 2025, në datat 17 – 19 Nëntor 2025, Dubai.**

Në datat 17-19 nëntor 2025, AIDA organizoi pjesëmarrjen me stendë shqiptare për herë të parë panairin Natural Organic Dubai 2025. Në këtë panair morën pjesë 5 kompani, 1 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 1 kompani nga sektori i ullinjve dhe i vajit të ullirit, 1 kompani nga sektori i lëngjeve të frurave dhe ujit, 2 kompani nga sektori i vajrave esenciale. Kompanitë realizuan 205 kontakte me kompani të huaja.

PROMOVIMI I EKSPORTEVE DHE MBËSHTETJA E NVM-VE

Fondi “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” për vitin 2025

AIDA për vitin 2025, menaxhoi Fondin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” i cili synon rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të tyre lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

Vlera totale e këtij fondi e vënë në dispozicion për NVM-të ka qenë në masën 131,830,000 lekë.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka publikuar në faqen e saj zyrtare, thirrjen për “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, për vitin 2025.

Thirrja për aplikime qëndroi e hapur për 30 ditë kalendarike, nga data 30 janar 2025 deri me datë 28 shkurt 2025. Gjithsej aplikuan 443 subjekte.

Sesionet informuese:

AIDA për të qënë sa më pranë biznesit edhe subjekteve që nuk janë familjarë me metodat digjitale të komunikimit, AIDA, zhvilloi 5 sesione informuese mbi thirrjen, të parashikuara për t’u zhvilluar në qarqet kryesore: Tiranë, Durrës, Fier-Vlorë, Lezhë-Shkodër, Pogradec-Korçë.

1. Skema e mbështetjes financiare për zërin shpenzimet korente, mbulon kostot e mëposhtme:

- Ø Certifikim i standardeve të prodhimit/shërbimit (përfshirë konsulencën përkatëse në fazën përgatitore);
- Ø Përmirësim i produktit përmes etiketimit, ambalazhimit;
- Ø Trajnime të stafit të ndërmarrjes për rritje kapacitetesh në fusha të tilla si: menaxhimi i teknologjive digjitale/inovatore, rrjetet e prokurimit, shërbime marketingu, zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së biznesit, sisteme të reja logjistike softëerike apo pajisje të reja, etj, dhe pajisje me certifikatat përkatëse nga subjekte të licencuara për trajnime;
- Ø Pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare me stenda të gatshme të ndërtuara nga panairi;
- Ø Krijimi i aplikacioneve apo platformave në funksion të zhvillimit të proceseve lidhur me tregtinë elektronike/e-commerce, produkteve të reja dhe/ose shërbimeve, për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend dhe rajon për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike etj;
- Ø Përgatitja e materialeve promovuese si: banera, fletëpalosje, katalogë, broshura për përmirësim të imazhit të NMVM-ve (jo më shumë se 20% e kostos totale të projektit).

2. Skema e mbështetjes financiare për zërin shpenzimet kapitale, mbulon kostot e mëposhtme:

1.1 Projekti për Konkurrueshmërinë

- Ø blerjen e makinerive që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe të përmirësimit të cilësisë së produktit.

1.2 Projekti për Mbështetjen e Artizanatit

- Ø blerjen e makinerive tradicionale dhe/ose teknologjike për të përmirësuar kushtet e punës për biznesin;
- Ø blerjen e aplikacioneve dhe/ose programeve E-commerce

Tabela e fondeve të disbursuara për vitin 2025.

Fondet e AIDAs 2025	Buxheti I Alokuar për	Numri I aplikimeve	Numri I kompanive	Buxheti I disbursuar në
Skema 1	100,000,000	249	56	100,000,000
Fondi I Konkurrueshmëri	21,830,000+873,	174	19	22,703,166
Fondi I Ekonomisë	10,000,000	20	10	9,126,667
Totali	131,830,000	443	85	131,829,833

“Zan’Art” me fokus nxitjen e bizneseve kreative

Eventi “Zan’Art”, u mbajt në datën 30 prill 2025, në Tiranë.

Qëllimi kryesor i eventit “Zan’Art” ishte të promovojë trashëgiminë kulturore përmes artizanatit dhe të krijojë mundësi konkrete për rritjen e vizibilitetit dhe shitjeve të produkteve artizanale. Ky event kishte për qëllim jo vetëm promovimin por ndërveprimin me target grupe të interesuara për produktet e tyre duke menduar zgjerimin e tregjeve. Nga ana tjetër, në këtë event u organizuan tavolina diskutimit/panelet mes aktoreve të sektorit dhe institucioneve shtetërore për të adresuar sfidat e artizanatit në Shqipëri dhe planet strategjike. Një mundësi unike promovimi, ndërveprimi dhe diskutimi.

Ky event lindi si një nevojë për të ofruar një hapësirë të dedikuar, ku artizanët tanë mundën të prezantojnë produktet e tyre autentike, ku arritën të ndërveprojnë me publikun dhe aktorë të tjerë të tregut, si dhe mundësinë për krijimin e partneritete të reja për zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve të tyre. Zan’Art krijoi një urë të gjallë ndërmjet brezave, duke i rikthyer artizanatit shqiptar vendin që meriton në shoqëri – jo thjesht si mjeshtëri, por si një formë e gjallë e trashëgimisë kulturore. Ky event shërbeu si një pedestal për duar-artët, ata që me pasion dhe durim ruajnë dhe përcjellin vlerat tona kombëtare. Çdo qepje, gdhendje, thurje apo ngjyrosje mbarë një histori – një frymë të hershme që flet për identitetin tonë, për rrënjët dhe shpirtin e këtij vendi. Zan’Art ishte një thirrje për ta vlerësuar të bukurën e krijuar me dorë, për të dëgjuar zërin e heshtur të zanateve dhe për të rindërtuar lidhjen emocionale me atë që është autentike, e thellë dhe e trashëguar.

Eventi Zan’Art krijoi një hapësirë të dedikuar për promovimin dhe fuqizimin e artizanëve shqiptarë, duke i vendosur ata në qendër të vëmendjes si bartës të trashëgimisë sonë kulturore. Përmes këtij aktiviteti u arrit rritja e ndërgjegjësimit publik mbi vlerat e artizanatit tradicional, nxitja e blerjeve direkte dhe krijimi i mundësive të reja ekonomike për artizanët pjesëmarrës.

Gjithashtu, Zan’Art synoi ruajtjen dhe transmetimin e mjeshtërisë tradicionale tek brezat e rinj, duke i shndërruar këto profesione në mundësi të qëndrueshme punësimi, përmes organizimit të ëorkshopeve dhe demonstrimeve të zhvilluara gjatë gjithë eventit.

Në këtë event ishte i pranishëm Ministri i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit z. Blendi Gonxhe, përfaqësues nga Ministria e Turizmit, Ministria e Bujqësisë, Kryetarja e Unioinit të Dhomave të Tregëtisë, përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, përfaqësues nga Bashkitë e qyteteve me trashëgimi kulturore, përfaqësues të institucioneve kulturore si: Muze, Akademi Artesh. Aktiviteti u organizua në formën e një panairi të mirëfilltë, ku ekspozuan produktet e tyre rreth 35 biznese artizane, të sektorëve të kostumeve popullore, drurit, qeramikes, pocerisë, xhamit, pikturës, maskave artizanale, qendisjes, ushqimore, bizhuterisë etj.

Ky aktivitet pati fokus ndërgjegjësimit e bizneseve që kanë në fokus artizanët, dyqane që tregojnë produktet e artizanatit, struktura elitare akomoduese, partnerët dhe mbështetësit e këtij sektori, përfaqësuesit e tregjeve ndërkombëtare, përfshirë shpërndarësit, retailer-at, dhe organizatat ndërkombëtare, institucionet mbështetëse, si dhomat e tregtisë, ambasadat, dhe organizatat zhvillimore.

PLATFORMA E EKSPORTEVE

Platforma e Eksporteve (exportalbania.al) është konceptuar si një zgjidhje strategjike për të mbështetur ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, duke përforcuar misionin e AIDA-s për të ofruar shërbime me vlerë të shtuar që lidhen ngushtë me eksportin dhe rritjen e aktivitetit tregtar të sipërmarrjeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Platforma është publikuar në të gjitha rrjetet sociale të AIDA-s www.exportalbania.al. Përmes saj, kompanitë mund të regjistrohen dhe të krijojnë profile të detajuara, duke promovuar produktet dhe shërbimet e tyre për një audiencë globale. Bizneset e regjistruara përfitojnë gjithashtu akses ekskluziv në **Platformën “Compass”**, një mjet i vlefshëm që u mundëson atyre të identifikojnë dhe eksplorojnë tregje të reja, të lidhen me partnerë potencialë, distributorë dhe blerës, si dhe të shfrytëzojnë mundësi të reja biznesi në tregjet ndërkombëtare. Duke thjeshtuar procesin e aksesit në mbështetjen për eksport, platforma fuqizon kompanitë shqiptare të zgjerojnë praninë e tyre në tregje, të rrisin konkurrueshmërinë dhe të arrijnë sukses në tregun global.

AIDA organizoi gjatë muajit qershor, “Info Day” dhe “Takime door to door” me bizneset eksportuese të qarqeve, Shkodër, Gjirokastër, Elbasan, Durrës, Berat, (faza e parë) ku kanë bërë promovimin e platformës dhe sensibilizimin e kompanive eksportuese shqiptare për të përfituar nga shërbimet që ofron kjo platformë, dhe janë regjistruar 155 kompani eksportuese të sektorëve të ndryshëm në total. Gjatë vitit 2026 do vijojë faza e dytë me informimin dhe regjistrimin e bizneseve.

MBËSHTETJA E BIZNESEVE ME TRAJNIME PËR PËRMIRËSIMIN E RRJETEVE PËR KOMPANITË SHQIPTARE QË PRODHOJNË PRODUKTE “MADE IN ALBANIA”

Trajnimet u shërbejnë kompanive si një mjet thelbësor për rritjen e kapaciteteve profesionale, përmirësimin e aftësive menaxheriale dhe përshtatjen me standardet dhe kërkesat e tregut vendas dhe ndërkombëtar. Përmes trajnimeve, bizneset përfitojnë njohuri praktike mbi eksportet, marketingun, certifikimin, inovacionin dhe digjitalizimin, duke rritur efikasitetin operacional dhe cilësinë e produkteve apo shërbimeve. Njëkohësisht, ato ndihmojnë kompanitë të bëhen më konkurruese, të marrin vendime strategjike më të informuara dhe të identifikojnë mundësi të reja rritjeje, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm dhe zgjerimin e tyre në tregje të reja.

- **Trajmin i organizuar nga AIDA në bashkëpunim me Damiani&Partners dhe GIZ Albania në datat 3-4-5 Shkurt 2025.**

Temat e trajnimeve:

1. Kërkim dhe analizë tregu
2. Gadishmëria për eksport
3. B2B Matchmaking

Me kompanitë e sektorëve të ushqimit, bimëve medicinale dhe aromatike, veshje dhe lëkurë këpuca, dhe përpunim druri.

- **Trajmin i organizuar nga AIDA në bashkëpunim me Damiani&Partners dhe GIZ Albania në datën 3 Korrik 2025.**

Tema e trajnimit: “Gatishmëria për Eksport”

Me kompanitë e sektorëve agropërpunim, Pije dhe Ushqim, Druri dhe Produkte prej Druri.

Platforma “Akses në Financë”

Gjatë vitit 2025, platforma "Akses në Financë" u pasurua me një mesatare prej 3-4 thirrje të reja në muaj, duke arritur një total prej rreth 48 thirrjesh vjetore. Këto përfshinin thirrje për grante, financime dhe mundësi të tjera të rëndësishme për NVM-të dhe bizneset shqiptare. Larmia e thirrjeve kontribuoi në rritjen e angazhimit të përdoruesve dhe përmirësimin e aksesit të informacionit mbi financat.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, platforma "Access to Finance" (A2F) ka treguar angazhim të qëndrueshëm, me një rritje të dukshme të aktivitetit të përdoruesve gjatë periudhave kryesore të raportimit (3 muaj). Platforma regjistroi 316.466 angazhime totale duke treguar angazhim të qëndrueshëm dhe interes të lartë.

Trafiku total përfshin 1.2K përdorues të rinj, kryesisht nga burime si kërkimet organike dhe referimet, duke reflektuar impaktin, dukshmerinë dhe rëndësinë e platformës. Google (900 sesione) dhe aida.gov.al (+500 sesione) janë burimet kryesore, duke treguar efektivitetin e strategjive SEO të përdorur mbi platformë.

Ndërveprimet e përdoruesve theksuan interesin e madh për mundësitë financiare dhe grantet e ofruara nga platforma. Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e platformës dhe hapin rrugën për përmirësime të mëtejshme në përmbajtje dhe përvojën e përdoruesve.

PROJEKTE NË ZBATIM

EEN Albania

Projekti “Enterprise Europe Network Albania 2022–2025” është zbatuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në kuadër të programit SMP-COSME, bazuar në marrëveshjen nr. 101075194. Periudha e zbatimit ka qenë nga 15 prill 2022 deri më 30 qershor 2025. Projekti është përmbyllur me sukses dhe raporti final është miratuar nga autoriteti kontraktues.

Koordinimi i projektit është realizuar nga AIDA, në bashkëpunim me partnerët e konsorciumit:

- Qendra për Promovimin e Konkureshmërisë (CCP),
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës,
- Fondacioni Agjencia Rajonale e Zhvillimit SME (RDA-Tirana),
- Dhoma Ekonomike e Grave të Shqipërisë (WECA),
- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (NASRI) si partner i asociuar.

Ky bashkëpunim ka garantuar mbulim sektorial dhe rajonal, si dhe integrim të dimensionit të inovacionit dhe kërkimit në shërbimet e ofruara.

Projekti ka pasur si objektiv kryesor rritjen e konkurrueshmërisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) shqiptare përmes:

- shërbimeve këshillimore të specializuara,
- ndërkombëtarizimit dhe partneriteteve B2B,
- mbështetjes për akses në financë,
- orientimit drejt tranzicionit digjital dhe të gjelbër.

Rezultatet e arritura tregojnë një performancë mbi targetet e parashikuara në disa indikatorë kyç, duke reflektuar një rritje të qartë të ndikimit të rrjetit në ekosistemin e NVM-ve shqiptare.

Konteksti Strategjik dhe Roli Institucional

EEN Albania operon si pjesë e rrjetit më të madh evropian për mbështetjen e biznesit, me fokus në:

- integrimin e NVM-ve shqiptare në tregun e BE-së,
- rritjen e kapaciteteve për inovacion,
- përmirësimin e standardeve dhe certifikimeve,
- krijimin e partneriteteve ndërkombëtare dhe kombëtare

Koordinimi i projektit nga AIDA, në bashkëpunim me partnerët e konsorciumit, ka garantuar shtrirje kombëtare dhe mbulim të balancuar sektorial.

Analiza e Performancës 2022–2025

Periudha 15 prill 2022 – 30 qershor 2025 përbën ciklin e plotë të implementimit të projektit “Enterprise Europe Network Albania”, me raport final të miratuar nga autoriteti kontraktues. Analiza e performancës tregon tejkalim të konsiderueshëm të indikatorëve kyç dhe rritje progresive të ndikimit të rrjetit në ekosistemin e NVM-ve shqiptare.

Mbështetja direkte për NVM-të

Gjatë periudhës së zbatimit janë asistuar gjithsej 1,456 NVM, kundrejt objektivit fillestar prej 1,000 ndërmarrjesh. Kjo përfaqëson një realizim prej 145.6% të targetit, ose 456 ndërmarrje më shumë se sa ishte planifikuar.

243 klientë unikë janë përfshirë në mënyrë të strukturuar në procesin “Network Client Journey”, kundrejt objektivit prej 110. Realizimi është 221% e targetit, duke treguar rritje të angazhimit afatgjatë dhe ofrim të shërbimeve me thellësi më të madhe.

Janë realizuar 248 Advisory Achievements (AAs), kundrejt objektivit prej 30. Kjo përfaqëson një realizim prej 826% të targetit, duke reflektuar intensitet të lartë të ndërhyrjeve këshillimore dhe ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e ndërmarrjeve.

Në dimensionin e partneriteteve ndërkombëtare janë finalizuar 27 Partnership Agreements (PAs). Ky indikator përfaqëson rezultate konkrete të ndërkombëtarizimit dhe integritit në zinxhirë vlerash ndërkombëtarë

Këto të dhëna tregojnë:

- rritje të kërkesës për shërbime të strukturuar,
- rritje të besimit të komunitetit të biznesit ndaj EEN Albania,
- kapacitet operacional të konsoliduar të konsorciumit.

Digjitalizimi dhe inovacioni

Gjatë ciklit 2022–2025, **64 NVM** janë mbështetur drejtpërdrejt në procesin e transformimit digjital.

Ndërhyrjet kanë përfshirë:

- implementimin e platformave e-commerce,
- strategji marketingu digjital,
- adoptim të mjeteve CRM dhe ERP,
- zhvillim të modeleve të biznesit online dhe hibride.

Kjo mbështetje ka ndikuar në:

- rritjen e kapaciteteve për operim në tregje ndërkombëtare,
- përmirësimin e prezencës digjitale të bizneseve,
- rritjen e rezistencës ndaj luhatjeve të tregut.

Në mënyrë të tërthortë, shërbimet e inovacionit kanë ndihmuar ndërmarrjet të përmirësojnë proceset e brendshme, efikasitetin operacional dhe pozicionimin konkurrues.

Aksesi në financë

Në kuadër të mbështetjes për akses në financë, 45 NVM janë asistuar në proces aplikimi në programe dhe instrumente si:

- Horizon Europe
- Single Market Programme (SMP)
- InvestEU
- Skema kombëtare të mbështetjes
- iniciativa EENergy

Veçanërisht, në kuadër të EENergy janë realizuar 14 aplikime të suksesshme, duke siguruar mbështetje financiare për ndërhyrje në eficiencë energjetike dhe tranzicion të gjelbër.

Ky dimension ka forcuar lidhjen mes ndërmarrjeve shqiptare dhe instrumenteve të Bashkimit Evropian, duke rritur shkallën e ndërveprimit me mekanizma të avancuar financimi.

Ndërkombëtarizimi dhe partneritetet

Në kuadër të ndërkombëtarizimit, EEN Albania ka organizuar dhe/ose ka mbështetur pjesëmarrjen në evente ndërkombëtare dhe B2B, duke përfshirë:

- Match-Maker Albania 2025
- Green Days Pollutec
- EU-WB6 Investment Forum
- Slush'd
- Business Mission Selanik

Mbi **51 NVM** shqiptare kanë përfituar ekspozim të drejtpërdrejtë në këto platforma ndërkombëtare.

Si rezultat konkret janë finalizuar **27 marrëveshje partneriteti (PAs)**, të cilat përfaqësojnë bashkëpunime në tregti, teknologji, furnizim dhe projekte të përbashkëta.

Kjo tregon një orientim të qartë drejt:

- integritimit në tregun e BE-së,
- zgjerimit të rrjeteve të bashkëpunimit,
- rritjes së kapaciteteve për eksport.

Shtrirja territoriale dhe komunikimi

Shërbimet e projektit janë ofruar në **15 qytete të Shqipërisë**, duke garantuar qasje gjithëpërfshirëse dhe balancim territorial.

Janë organizuar:

- Info Days,
- trajnime tematike,
- ëebinare informuese,
- takime ndërgjegjësimit mbi programet e BE-së dhe standardet evropiane.

Këto aktivitete kanë kontribuar në:

- rritjen e ndërgjegjësimit mbi instrumentet evropiane,
- zgjerimin e bazës së përfituesve,
- përmirësimin e transparencës së shërbimeve.

Forcimi i partneriteteve strategjike përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit

Gjatë periudhës 2022–2025, në funksion të rritjes së kapaciteteve për bashkëpunim ndërkombëtar dhe aplikime të përbashkëta në projekte, EEN Albania ka ndërmarrë hapa konkretë për formalizimin e partneriteteve strategjike përmes nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit (MoU).

Është nënshkruar MoU me EIT Community HUB Albania, me fokus mbështetjen e ndërmarrjeve inovative dhe orientimin e tyre drejt instrumenteve të komuniteteve të inovacionit të EIT. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë asistuar 3 SME në proces aplikimi, duke rritur ndërveprimin me ekosistemin evropian të inovacionit.

Në dimensionin rajonal, është nënshkruar MoU me Foundation Business Start-Up Centre Bar (BSC Bar) dhe Chamber of Economy of Montenegro, me të cilët është aplikuar dhe fituar një projekt në kuadër të programit IPA Albania–Montenegro (IPA AL-MNE). Ky bashkëpunim ka forcuar dimensionin ndërkufitar të aktiviteteve dhe ka krijuar bazë për zhvillim të projekteve të përbashkëta në fushën e mbështetjes së NVM-ve.

Gjithashtu, është formalizuar bashkëpunimi me Italy-Czech Republic Chamber of Commerce (CCIRC), Itali, me qëllim promovimin e lidhjeve tregtare dhe lehtësimin e partneriteteve biznesore ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare dhe atyre në tregjet italiane dhe çeke.

Në nivel rajonal është nënshkruar MoU me Prishtina REA, me të cilën është bashkëpunuar në aplikime të përbashkëta projektsh dhe në organizimin e misioneve të përbashkëta biznesi, duke kontribuar në integrimin ekonomik rajonal dhe në rritjen e mobilitetit të NVM-ve.

Gjithashtu, më 27 mars 2025, në Tiranë, është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Enterprise Europe Netëork-Hellas pranë Epimelitirio Ioanninon (Chamber of Ioannina) dhe Enterprise Europe Netëork pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Marrëveshja synon vendosjen e një baze bashkëpunimi në mirëbesim për iniciativa të përbashkëta me përfitim reciprok, forcimin e aktivitetit eksportues të NVM-ve greke dhe shqiptare, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre, si dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave EEN të Greqisë dhe Shqipërisë. Memorandumi nuk krijon detyrime financiare apo ligjore, por përcakton kuadrin e bashkëpunimit përmes shkëmbimit të informacionit, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta B2B, misioneve të biznesit dhe iniciativave për ndërkombëtarizim.

Në tërësi, këto marrëveshje nuk kanë mbetur në nivel deklarativ, por janë materializuar në aplikime konkrete, projekte të fituara dhe aktivitete të përbashkëta ndërkombëtare, duke forcuar dimensionin strategjik të EEN Albania në rajon dhe më gjerë.

Përmbledhje Analitike

Cikli 2022–2025 ka rezultuar me:

- 145.6% realizim të targetit të NVM-ve të asistuara
- 221% realizim të targetit për klientë të strukturuar
- 826% realizim të targetit për arritje këshillimore
- 27 marrëveshje partneriteti konkrete
- 14 aplikime të suksesshme në EENergy

Performanca mbi targetet në disa indikatorë kyç dëshmon:

- konsolidim institucional të konsorciumit,
- rritje të cilësisë së shërbimeve,
- rritje të ndikimit të EEN Albania në konkurrueshmërinë e NVM-ve shqiptare.

Në terma strategjike, ky cikël nuk ka qenë thjesht një periudhë implementimi, por një fazë konsolidimi ku rrjeti ka kaluar nga prezencë informuese në instrument operativ të ndërkombëtarizimit dhe inovacionit, çka e diferencion këtë projekt si një instrument që prodhon gravitet ekonomik.

Analiza e Performancës 2025–2028

Projekti “Enterprise Europe Netëork Albania” për periudhën 2025–2028 zbatohet në kuadër të programit SMP-COSME-2024-EEN, me financim nga European Innovation Council and SMEs Executive Agency (EISMEA), sipas marrëveshjes nr. 101236267. Periudha e zbatimit shtrihet nga 1 korriku 2025 deri më 31 dhjetor 2028 dhe aktualisht projekti ndodhet në fazën e parë të implementimit.

Koordinimi realizohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me partnerët e konsorciumit si:

- Qendrën për Promovimin e Konkurrueshmërisë (CCP),
- Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Durrës,
- Fondacionin Agjencia Rajonale e Zhvillimit SME (RDA-Tirana)
- Dhomën Ekonomike të Grave të Shqipërisë (ËECA).

Vlera totale e financimit arrin në 594,653.46 euro, me strukturë bashkëfinancimi 60% nga programi dhe 40% në nivel konsorciumi, duke reflektuar vazhdimësi të angazhimit institucional dhe partneritet të konsoliduar.

Projekti vijon të ofrojë një paketë të integruar shërbimesh për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, me fokus në këshillim për eksport, inovacion, digjitalizim dhe qëndrueshmëri, lehtësim të partneriteteve ndërkombëtare përmes aktiviteteve B2B dhe matchmaking, informim mbi politikat dhe programet e Bashkimit Evropian, si dhe mbështetje për akses në financim dhe instrumente evropiane.

Gjatë muajve të parë të zbatimit janë shërbyer 86 ndërmarrje kundrejt objektivit total prej 1,000 për të gjithë periudhën e projektit, ndërsa 16 klientë unikë janë përfshirë në mënyrë të strukturuar në “Netëork Client Journey”, nga 110 të parashikuar. Në aspektin e arritjeve konkrete janë realizuar 5 arritje këshillimore dhe 1 marrëveshje partneriteti, në raport me objektivin prej 30 për secilën kategori gjatë ciklit të plotë të projektit. Duke qenë se projekti është në fazë fillestare, këto rezultate përbëjnë bazën e nisjes dhe pritjet rritje progresive e performancës në vijim të implementimit.

Në tërësi, faza e parë e projektit reflekton vazhdimësinë e rolit të EEN Albania si instrument kyç për rritjen e konkurrueshmërisë dhe ndërkombëtarizimit të NVM-ve shqiptare, me pritshmëri për intensifikim të aktivitetit dhe thellim të ndikimit në vitet e ardhshme.

EEN2EIC Subgrant

Në kuadër të forcimit të sinergjive ndërmjet EEN dhe European Innovation Council, AIDA ka përfituar një subgrant nëpërmjet iniciativës EEN2EIC.

Ky instrument ka synuar identifikimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve me potencial të lartë inovacioni për t'u orientuar drejt instrumenteve të EIC, përfshirë EIC Accelerator. Përmes këtij subgranti janë realizuar aktivitete të specializuara këshillimi, vlerësim i nivelit të inovacionit, orientim strategjik dhe mbështetje për përgatitjen e aplikimeve në programe të avancuara të BE-së.

EEN2EIC ka kontribuar në rritjen e cilësisë së pipeline-it të kompanive inovative dhe në afrimin e tyre me ekosistemin evropian të deep-tech dhe teknologjive me ndikim të lartë.

Projekti IPA Cross-Border Albania – Montenegro

Projekti “Skills for Sustainable Employment and Inclusive Economic Growth of Cross-Border Region of Albania and Montenegro – Skills for Jobs Albania–Montenegro”, i financuar në kuadër të Programit IPA II Cross-Border Cooperation Montenegro – Albania 2014–2020, u zbatua gjatë periudhës 1 shkurt 2023 – 31 janar 2025, me një buxhet total prej 290,000 Euro. Projekti u koordinua nga Foundation Business Start-Up Centre Bar (BSC Bar), në partneritet me Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Dhomën Ekonomike të Malit të Zi.

Qëllimi kryesor i projektit ishte lehtësimi i aksesit në tregun e punës për të rinjtë dhe gratë në zonat ndërkufitare të Shqipërisë dhe Malit të Zi, përmes rritjes së aftësive profesionale dhe sipërmarrëse në sektorë me potencial zhvillimi si turizmi, TIK-u, mikpritja, gastronomia dhe artizanati. Projekti synoi gjithashtu forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe krijimin e një marke të përbashkët promovuese për produktet dhe shërbimet e rajonit.

Në kuadër të zbatimit të projektit, AIDA luajti një rol kyç në koordinimin dhe realizimin e aktiviteteve në territorin shqiptar, veçanërisht në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe. Gjatë projektit u organizuan praktika profesionale për të rinj dhe gra të papuna, trajnime për guidë turistike kombëtare, programe mentorimi për zhvillimin e ideve të biznesit, si dhe mbështetje financiare për startup-et më të suksesshme të përzgjedhura nga juria e projektit.

Në përfundim të implementimit, projekti rezultoi i suksesshëm në arritjen e objektivave të tij, duke kontribuar në rritjen e aftësive profesionale dhe sipërmarrëse të përfituesve, forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe promovimin e mundësive të reja për punësim dhe vetëpunësim në rajon. Implementimi i projektit është përmbyllur me sukses, në përputhje me planin e veprimit dhe objektivat e përcaktuara, fakt i konfirmuar edhe nga autoriteti kontraktues.

AIDA DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

AIDA - ABSL

Në janar 2025, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Association of Business Service Leaders (ABSL Albania), me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit mbi sektorët BPO, ITO, SSC dhe R&D në Shqipëri. Marrëveshja synon realizimin e aktiviteteve me karakter edukativ, përfshirë trajnime, workshope dhe webinare, si dhe organizimin e tryezave të përbashkëta me aktorët kryesorë të sektorit, me qëllim identifikimin e problematikave dhe nevojave të tregut. Gjithashtu, palët parashikojnë shkëmbimin periodik të statistikave mbi zbatueshmërinë dhe aktivitetin e këtyre sektorëve në Shqipëri, shpërndarjen reciproke të kërkesave për bashkëpunim me kompani, organizata dhe institucione vendase ose të huaja, si dhe shkëmbimin e informacionit lidhur me organizimin e panairove, ekspozitave dhe konferencave me karakter kombëtar ose ndërkombëtar.

AIDA – MËSIAD ALBANIA

Në shkurt 2025, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me MËSIAD Albania, me qëllim sigurimin e shkëmbimit të rregullt të informacionit mbi ekonominë dhe investimet, si dhe ofrimin e asistencës në zbatimin e projekteve bashkëpunuese. Marrëveshja parashikon shkëmbimin e të dhënave ekonomike dhe statistikore, shënimeve, raporteve vjetore dhe botimeve periodike në interes të të dy palëve, si dhe shpërndarjen reciproke të informacionit mbi kompanitë turke dhe shqiptare nëpërmjet krijimit dhe përdorimit të databazave të përbashkëta. Palët mbështesin njëra-tjetrën në organizimin dhe realizimin e delegacioneve dhe misioneve të biznesit, informojnë reciprokisht mbi organizimin e ekspozitave dhe panairove tregtare me karakter kombëtar ose ndërkombëtar, si dhe inkurajojnë zhvillimin e turizmit ndërmjet vendeve, duke kontribuar në organizimin e programeve tregtare dhe turistike.

AIDA - INVEST NORTH MACEDONIA

Në kuadër të Matchmaker Albania 2025, në muajin mars, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Agency for Foreign Investments and Export Promotion of the Republic of North Macedonia (Invest North Macedonia), me qëllim sigurimin e shkëmbimit të informacionit ekonomik dhe tregtar, promovimin e bizneseve me përfitim të ndërsjellë, krijimin e marrëdhënieve ndërmjet organizatave të biznesit dhe zgjerimin e bashkëpunimit të tyre me përfshirjen e dhomave të tjera të tregtisë. Marrëveshja synon gjithashtu informimin mbi panairove, ekspozita dhe takime biznesi me fokus zhvillimin ekonomik, si dhe ndërmarrjen e veprimeve për shkëmbimin e ndërsjellë të përvojave, forcimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit për përmirësimin e mjedisit të biznesit.

AIDA - RAS

Në kuadër të Matchmaker Albania 2025, në muajin mars, AIDA nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Development Agency of Serbia (RAS), me qëllim sigurimin e shkëmbimit të informacionit ekonomik dhe tregtar, promovimin e bizneseve me përfitim të ndërsjellë, krijimin e marrëdhënieve ndërmjet organizatave të biznesit dhe zgjerimin e bashkëpunimit të tyre me përfshirjen e dhomave të tjera të tregtisë. Marrëveshja synon gjithashtu informimin mbi panairove, ekspozita dhe takime biznesi me fokus zhvillimin ekonomik, si dhe shkëmbimin e përvojave, forcimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit për përmirësimin e mjedisit të biznesit.

AIDA - BCCA

Në kuadër të Matchmaker Albania 2025, në muajin mars, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me The United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland Chamber of Commerce in Albania (BCCA), me qëllim sigurimin e shkëmbimit të informacionit ekonomik dhe tregtar, promovimin e bizneseve me përfitim të ndërsjellë, krijimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve ndërmjet organizatave të biznesit, informimin mbi panaire, ekspozita dhe takime biznesi me fokus zhvillimin ekonomik, si dhe ndërmarrjen e veprimeve për shkëmbimin e përvojave dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit për përmirësimin e klimës së biznesit.

AIDA – KAZAKH INVEST

Në kuadër të Matchmaker Albania 2025, në muajin mars, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Kazakh Invest, me qëllim tërheqjen e kompanive kazakistane dhe shqiptare të interesuara për zhvillimin e biznesit përmes investimeve të huaja, sigurimin e informacionit publik mbi projektet e investimeve në Shqipëri dhe Kazakistan, si dhe organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete dhe ngjarje ndërkombëtare me interes të ndërsjellë për të dy palët.

AIDA - DPT

AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave statistikore mbi punësimin dhe subjektet me status strategjik, si dhe organizimin e takimeve të përbashkëta për koordinim institucional dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

AIDA - FIPA

Në kuadër të forumit WB6 – EU, në muajin tetor, AIDA nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Agjencinë e Promovimit të Investimeve në Bosnjë dhe Hercegovinë (FIPA), duke shënuar një hap të ri për forcimin e bashkëpunimit rajonal. Marrëveshja synon fuqizimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet dy agjencive dhe nxitjen e iniciativave të përbashkëta që mundësojnë realizimin e projekteve dhe ideve të reja të investimeve në rajon.

AIDA – SIMEST S.P.A

Në kuadër të mbledhjes së parë ndërqeveritare midis Italisë dhe Shqipërisë, në muajin nëntor, AIDA nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me SIMEST, duke krijuar një instrument të ri për rritjen e investimeve italiane në Shqipëri. Marrëveshja synon promovimin e përbashkët të Shqipërisë si një destinacion i favorshëm për investime italiane në sektorë si energjia, turizmi, bujqësia, prodhimi dhe teknologjia. Dokumenti përcakton gjithashtu lehtësimin e bashkëpunimit mes bizneseve përmes organizimit të misioneve ekonomike, forumeve dhe eventeve të dedikuara për investitorët, shkëmbimin e informacionit ekonomik dhe tregtar për të mbështetur vendimmarrjen për investimet e huaja direkte, si dhe identifikimin e projekteve të përbashkëta strategjike, që mund të mbështeten nga instrumentet financiare të SIMEST dhe strukturat mbështetëse të AIDA-s.

AIDA - GAFI

Në kuadër të Forumit Ekonomik Shqipëri – Egjipt, në muajin dhjetor AIDA nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Autoritetin e Përgjithshëm për Investime dhe Zonat e Lira të Republikës Arabe të Egjiptit (GAFI), me qëllim thellimin e bashkëpunimit në fushën e investimeve përmes shkëmbimit të informacionit, praktikave më të mira dhe përvojave institucionale, si dhe përmirësimin e klimës së biznesit në të dy vendet.

AIDA, PJSË E TRYEZAVE TË RËNDËSISHME

- **Grupi i Përbashkët të Punës për Investime, Vjenë, Austri.**

AIDA mori pjesë në Grupin e Përbashkët të Punës për Investime dhe në tryezën e rrumbullakët të projektit RegioTrade, që u zhvilluan në datat 12 – 13 Qershor 2025, në Vienë, Austri.

Takimi i Grupit të Përbashkët të Punës për Investimet u organizua nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), me mbështetjen e Komisionit Evropian, Grupit të Bankës Botërore dhe GIZ. Qëllimi i tij ishte avancimi i punës teknike mbi rezultatet konkrete në kuadër të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM), me fokus në politikat e përbashkëta të investimeve.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga agjencitë e investimeve dhe ministrinë respektive që mbulojnë politikat e investimeve nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnje dhe Hercegovina. Gjatë sesioneve u diskutuan temat kryesore si më poshtë:

1. Vlerësimi i gatishmërisë për investime të qëndrueshme.
2. Lehtësimi i investimeve.
3. Krijimi i një klime të qëndrueshme.

Ndërsa, tryeza e rrumbullakët mbi projektin RegioTrade u organizua nga GIZ dhe solli në vëmendje mundësitë për bashkëpunim dhe koordinim më të mirë në funksion të investimeve të qëndrueshme dhe mekanizmave për parandalimin e mosmarrëveshjeve. Projekti synon të adresojë sfidat më kritike të integritimit ekonomik rajonal.

- **Grupi i Përbashkët të Punës për Investime, Bar, Mal i Zi.**

AIDA mori pjesë në Grupin e Përbashkët të Punës për Investime, që u zhvilluan në datën 3 Shtator 2025, në Bar, Mal i Zi.

Takimi i Grupit të Përbashkët të Punës për Investimet u organizua nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), me mbështetjen e Komisionit Evropian. Qëllimi i tij ishte avancimi i paketës së dokumentave të lidhura me investimet në kuadër të Procesit të Berlinit.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga agjencitë e investimeve dhe ministrinë respektive që mbulojnë politikat e investimeve nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnje dhe Hercegovina.

Gjatë diskutimeve u theksua se puna në nivel teknik për Rekomandimet mbi Investimet e Huaja të Qëndrueshme në WB6 dhe për Parimet e Përbashkëta për Lehtësimin e Investimeve është përmbyllur, duke reflektuar edhe komentet e dërguara nga pjesëmarrësit.

Gjithashtu, u diskutua dokumenti mbi Klauzolat Model për Investime të Qëndrueshme, si edhe Toolkit-i i Politikave për Investime të Qëndrueshme, për të cilët u ra dakord se nevojitet më shumë kohë për shqyrtim. Pas marrjes së komenteve shtesë, RCC do të përgatisë versionin final dhe do ta ndajë atë për konfirmim përfundimtar nga grupi.

- **Forumi i Biznesit të Procesit të Berlinit**

AIDA mori pjesë në Forumin e Biznesit të Procesit të Berlinit, i cili u hap me panelin “Investimet në Ballkanin Perëndimor”, një aktivitet i bashkorganizuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) dhe Departamenti i Tregtisë dhe Biznesit i Mbretërisë së Bashkuar.


Në këtë panel morën pjesë përfaqësues të gjashtë agjencive të promovimit të investimeve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfaqësues të UK Export Finance, investitorë ndërkombëtarë, si dhe përfaqësues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), përfshirë edhe Drejtoreshën Ekzekutive, znj. Laura Saro.

Qëllimi i takimit ishte prezantimi i projekteve strategjike të rajonit dhe eksplorimi i mundësive të reja për investime të qëndrueshme dhe zhvillim në fushën e energjinë së pastër. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për nxitjen e rritjes ekonomike, inovacionit dhe tranzicionit të gjelbër në Ballkanin Perëndimor.

INVESTIME STRATEGJIKE

Në zbatim të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është bërë e mundur që investimet vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjikë, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përshejtuara dhe favorizuese. Për sa parashikohet në këtë ligj dhe aktet e dala për zbatim të tij, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS)
- Agjent asistues i investitorit strategjik



Referuar legjisllacionit të investimeve strategjike, AIDA në cilësinë e One Stop Shop ka të gjithë autoritetin e nevojshëm për të pranuar dosjet, shqyrtuar, kontrolluar përputhshmërinë e aplikimeve, dhe në cilësinë e sekretariatit teknik të koordinojë gjithë procesin deri në vendimarrjen e Komitetit të Investimeve Strategjike.

Në këtë aspekt, One Stop Shop:

- kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjikë (pra dy statute të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planet kombëtare të rregullimit të territorit, proces i cili përfshin një sërë institucionesh njëkohësisht;
- koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.

Duke qenë se procedurat kanë krijuar tashmë precedent, edhe mbledhjet e KIS për një projekt janë reduktuar. (Ligji nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikon që KIS ka 30 ditë pune afat për të marrë një vendim lidhur me një projekt investimi që i propozohet nga Grupi Operacional). Njëkohësisht sipas ligjit, KIS, pasi aprovon statusin strategjik, duhet të miratojë dhe planin e veprimit (masat shtetërore) për projektin në shqyrtim. Për këtë arsye, Grupet Operacionale japin kontributin e tyre, njëkohësisht, edhe për vlerësimin teknik të projektit, edhe për planin e veprimit mbi masat shtetërore që vlerësohen se duhet t’i jepen projektit. Mbi këtë bazë, Sekretariati Teknik paraqitet në KIS me dy materiale njëherazi: (i) raportin e vlerësimit teknik dhe (ii) planin e veprimit. Afati 30 ditor shfrytëzohet për të zbardhur vendimin dhe rekomandime shtesë të KIS.

Projekte të vlerësuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë vitit 2024 dhe 2025.

Projekte të shqyrtuara nga AIDA 2024-2025:

VITI	2024	2025	TOTALI
Projekte totale të trajtuara	21	7	28
Projekte të miratuara	7	6	13
Projekte të refuzuara	10	1	11
Shqyrtime të tjera*	4	2	6

Përgjatë vitit 2025, pranë AIDA kanë aplikuar 7 (shtatë) subjekte nga të cilët 6 (gjashtë) prej tyre kanë përfituar statusin strategjik, duke përfituar njëkohësisht dhe masat mbështetëse të parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike, ndërsa 1 (një) prej tyre nuk i është pranuar kërkesa për përfitimin e statusit strategjik.

Përveç sa më sipër, përgjatë vitit 2025 AIDA ka asistuar në fazë paraprake 27 (njëzet e shtatë) projekte në total. Çdo subjekt aplikues, mbahet i informuar sistematikisht nga stafi i AIDA lidhur me kërkesën e tij, duke u asistuar mbi procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin përkatës që duhet të dorëzohet.

Projekte të aplikuara për përfshirjen në procedura administrative të legjisllacionit të investimeve strategjike me qëllim përfitim statusi strategjik, të cilat janë në proces vlerësimi janë 4 (katër) projekte në total.

Shqyrtimet e tjera që ka bërë KIS përgjatë vitit 2024-2025, kanë të bëjnë me:

- pranimin për shtyrje afati të statusit strategjik për 3 projekte;
- mospranimin për shtyrje afati të statusit strategjik 1(një) projekt;
- për disa shtesa dhe ndryshime të statusit strategjik për 2(dy) projekte;

Projektet sipas sektorëve strategjikë:


Projektet e shqyrtuara përgjatë vitit 2025 i përkasin sektorit të turizmit, i cili ka numrin më të madh të projekteve të investimit (5), duke u ndjekur më pas nga sektori i energjisë (1) dhe (1) projekt që ka përfituar statusin “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë”, me vlerë investimi mbi 100 milion Euro.

Në krahasim me vitin 2024, në vitin 2025 janë trajtuar:


- 5 projekte në sektorin e turizmit, prej të cilëve janë miratuar 4 dhe është refuzuar 1;
- 1 projekt në sektorin e energjisë;
- 1 projekt “mbi 100 milion Euro”.

Të shprehura në formë grafike:

Në vitin 2024, projektet në sektorin e turizmit zunë 75% të projekteve të miratuara në total, sektori i TEDA zuri 13%, ndërsa agroturizëm 12%.



Në vitin 2025, projektet në sektorin e turizmit zunë 67 % të projekteve të miratuara në total, ndërkohë që sektori i energjisë zuri 16% dhe 17 % sektori i investimeve me vlerë mbi 100 milion Euro.



Monitorimi i projekteve strategjike

Procesi i monitorimit të projekteve që kanë përfituar statusin investim/investitor strategjik, ka si qëllim kryesor të sigurojë që projektet e investimit të arrijnë objektivat e tyre dhe të jenë në përputhje me planet e veprimit të miratuara me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky proces synon të pasqyrojë në mënyrë të përbledhur progresin financiar dhe fizik të investimit, përbushjen e objektivave, pengesat e hasura gjatë zbatimit, si dhe masat e propozuara për përmirësim. Për këtë arsye, të dhënat janë mbledhur në bashkëpunim me subjektet përgjegjëse, përmes dokumentacionit mbështetës.

Për vitin 2025, AIDA ka zhvilluar dy procese monitorimi të ndarë në dy 6 mujorë. Në këtë raportim janë përfshirë 22 projekte/subjekte, të cilët kanë raportuar bazuar në progresin dhe disponueshmërinë e të dhënave.

AIDA ka përgatitur Raportin 6 mujor për periudhën Janar – Qershor 2025 dhe është në fazë përgatitje të Raportit të 6 mujorit të dytë të vitit. Ky raport përbledhës monitorimi është përgatitur mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga subjektet që kanë përfituar statusin investim/investitor strategjik, në përputhje me legjislacionin e investime strategjike dhe formatin e skedës teknike të ecurisë së zbatimit të projektit të investimit të hartuar dhe përcjellë nga AIDA.

Raportimi i periudhës së parë, nxorri në pah se projektet paraqesin një ecuri të larmishme, ku disa janë në fazë të avancuar me ritme të qëndrueshme, ndonëse përballen me sfida teknike, klimatike apo infrastrukturore, ndërsa të tjera janë në faza përgatitore ose kanë progres minimal. Ndërkohë, një pjesë e projekteve kanë ende nevojë për përshejtim të procedurave dhe nisje të zbatimit konkret në terren. Në përgjithësi, vihet re një mbështetje dhe rol aktiv nga ana e institucioneve në asistimin e procedurave administrative për përshejtuara, si dhe dhënie asistence teknike për ndërhyrje infrastrukturore për të garantuar progres të qëndrueshëm dhe afate të projekteve të investimit strategjik.

Projektet janë duke avancuar, edhe pse me ritme të ulta drejt përmbushjes së objektivave të planifikuara. Megjithatë, disa prej tyre kanë hasur vonesa të përkohshme, të cilat kërkojnë mbështetje dhe ndërhyrje të koordinuar për vijuar me tej.

Konstatohet se subjektet investuese hasin vështirësi teknike gjatë zbatimit të projekteve duke qenë se përballen me situata të paparashikuara të terrenit. Gjatë procesit të monitorimit konstatohen mungesa në infrastrukturë qendrore publike për të lidhur me projektet private të investimit strategjik me zonën urbane.

Rezultatet si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike

Duke pasur parasysh aplikimin e legjislacionit për investimet strategjike, si dhe shtimin e numrit të investitorëve që kërkojnë aplikimin e masave asistuese apo mbështetëse nga AIDA dhe shteti shqiptar, duhet theksuar se ka një vlerësim tepër pozitiv mbi kuadrin ligjor ekzistues, pavarësisht se në fillimet e zbatimit të tij, investitorët mund të kenë qenë edhe skeptikë me efektivitetin e zbatimit të këtij ligji. Por sot, është fakt se ky legjislacion është liberal, jo diskriminues për investitorët, qofshin këta vendas apo të huaj, si dhe transparent, në drejtim të incentivave dhe programeve sektoriale, me anë të të cilit janë thjeshtëzuar edhe më tej procedurat administrative.

Tashmë, si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike, projektet e investimit që aplikojnë dhe asistohen nga AIDA kanë më shumë lehtësira në marrjen e lejeve zhvillimore apo lejeve të ndërtimit, kurse masat mbështetëse janë lehtësisht të zbatueshme dhe me procedura të përshejtuara.

Me ligjin nr. 8/2025, për një ndryshim në ligjin e investimeve strategjike nr.55/2015, u ndryshua afati i paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, duke parashikuar si afat datën 31 dhjetor 2026.

Duke parë ecurinë e zhvillimit që po merr së fundmi Shqipëria dhe kërkesat për investime në fushën e investimeve strategjike sipas parashikimeve të ligjit nr.55/2015, vlerësojmë si domosdoshmëri ndryshime ligjore në mënyrë që të mos kemi kufizime në afate aplikimi, por të jetë në vazhdimësi.

AIDA DHE MEDIA

Gjatë vitit 2025, drejtoria e marketingut të AIDA-s luajti një rol thelbësor në mbështetjen e objektivave strategjike të agjencisë, duke siguruar promovimin e vazhdueshëm të aktiviteteve, eventeve, shërbimeve dhe arritjeve institucionale. Përmes një qasjeje të integruar komunikimi, marketingu shërbeu si një instrument funksional në lidhjen e punës së sektorëve me publikun, bizneset, investitorët dhe partnerët ndërkombëtarë.

Marketingu ka shërbyer në mënyra të ndryshme si urë midis sektorëve të AIDA-s dhe publikut si: bizneset, investitorët, partnerët ndërkombëtarë dhe opinioni publik.

Aktivitetet janë përqendruar në:

- Promovimin e Shqipërisë si destinacion investimi
- Promovimin e produkteve "Made in Albania"
- Mbështetjen e SME-ve në eksport dhe ndërkombëtarizim
- Zhvillimin e sektorëve strategjikë (ICT/BPO, turizëm, industri kreative)
- Konsolidimin e imazhit institucional të AIDA-s

Marketingu shoqëroi eventet kryesore si para, gjatë dhe pas zhvillimit të tyre, duke përdorur materiale të loguara, infografikë, foto, video, reels dhe përmbajtje narrative, të përshtatura sipas objektivave të çdo aktiviteti.

Aktivitetet e marketingut u fokusuan në krijimin e përmbajtjes promovuese, prodhimin e materialeve të loguara, komunikimin në rrjetet sociale, bashkëpunimin me median dhe mbulimin e vazhdueshëm të arritjeve institucionale, duke siguruar koherencë vizuale dhe mesazh të unifikuar por edhe të përshtatur sipas kanaleve të komunikimit.

Nëpërmjet një strategjie të integruar komunikimi, që përfshiu eventet fizike, praninë digjitale, bashkëpunimin me median dhe prodhimin e materialeve promovuese, marketingu i AIDA-s ka arritur të krijojë një narrativë të qëndrueshme, të besueshme dhe të fuqishme për ekonominë shqiptare dhe rolin e agjencisë si nje lidhëse midis bizneseve, investitorëve dhe tregjeve globale.

Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimi

Një nga prioritetet kryesore të marketingut gjatë vitit 2025 ishte promovimi i Shqipërisë si një destinacion i besueshëm dhe konkurrues për investime të huaja direkte. Ky objektivi u mbështet përmes pasqyrit të eventeve të nivelit të lartë, forumeve ekonomike, takimeve dypalëshe dhe nismave strategjike që synonin tërheqjen e investitorëve ndërkombëtarë.

Evente madhore si Match Maker Albania 2025, Forumet Ekonomike Ndërkombëtare, FII – Future Investment Initiative, ITB Berlin, MIPIM Cannes, Forumi Shqipëri–Francë, Forumi Shqipëri–Turqi, Forumi Shqipëri–Japoni, EU–WB6 Investment Forum, Tirana Economic Forum, u trajtuan nga marketingu si fushata të plota komunikimi para–gjatë–pas eventit. Për secilin event u theksuan temat e diskutimit, sektorët prioritarë dhe roli i AIDA-s në ndërtimin e partneriteteve strategjike.

Ngjarja më e rëndësishme në këtë drejtim ishte Match Maker Albania 2025, event i më i madh vjetor për biznesin dhe investimet, i cili u promovua përmes një fushate të strukturuar komunikimi. Marketingu realizoi promovim paraprak për objektivat e eventit, sektorët prioritarë dhe mundësitë e investimit në Shqipëri, pasqyrim intensiv gjatë zhvillimit të tij dhe komunikim pas-eventit për rezultatet konkrete.

Qasja e marketingut:

Rrjetet sociale si Instagram, Facebook dhe LinkedIn u përdorën për:

- Infografë dhe video para eventeve
- Reels dhe stories live gjatë zhvillimit të eventit
- Albume, reels dhe video gjithëpërfshirëse pas përfundimit

Përmbajtja e postimeve u fokusua në:

- Mesazhe strategjike për investitorë
- Njoftime për panele, marrëveshje dhe projekte konkrete
- Pozicionimin institucional të AIDA-s
- Nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit (MoU)
- Prezantimin e projekteve strategjike
- Rolin e AIDA-s si ndërmjetës kyç mes institucioneve dhe investitorëve

Gjithashtu, faqja zyrtare e AIDA-s shërbeu si arkivë institucionale dhe pikë reference për:

- Agjendat
- Marrëveshjet
- Deklaratat dhe rezultatet kryesore

Gjatë vitit 2025, marketingu i AIDA-s integroi publikimin e të dhënave mbi rekordet e Investimeve të Huaja Direkte gjatë zhvillimit të eventeve dhe aktiviteteve kryesore. Këto të dhëna u përpunuan dhe u prezantuan në forma vizuale dhe mesazhe institucionale, të cilat u shpërndanë përmes rrjeteve sociale, faqes zyrtare dhe medias.

Forcimi i dukshmërisë së produkteve shqiptare dhe markës "Made in Albania"

Marketingu luajti një rol të rëndësishëm në promovimin e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, përmes mbështetjes së pjesëmarrjes së bizneseve shqiptare në panairë dhe ekspozita prestigjioze ndërkombëtare. Aktivitetet u fokusuan në ndërtimin e një imazhi të unifikuar dhe cilësor të produkteve "Made in Albania", duke nxjerrë në pah autenticitetin, cilësinë dhe potencialin eksportues të tyre.

Pjesëmarrja në panairë si BIOFACH 2025 në Gjermani, Wine Paris 2025 në Francë, Expo Food Athinë, Riga Food, Nordic Organic Food Fair në Suedi dhe Organic Expo Dubai u shoqërua me një komunikim të vazhdueshëm vizual dhe informues përmes rrjeteve sociale dhe grupit bashkëpunues të medias. Marketingu realizoi materiale grafike, video, foto dhe reels nga standat kombëtare, duke promovuar produktet organike, verërat autoktone, vajin e ullirit, produktet ushqimore dhe bimët medicinale shqiptare etj.

Përveç pasqyrimin të pranishëm në panairë, marketingu zhvilloi edhe storytelling për histori suksesi, duke prezantuar biznese që kanë përfituar nga mbështetja e AIDA-s dhe kanë arritur të zgjerojnë praninë e tyre në tregjet ndërkombëtare. Këto materiale shërbyen për të rritur besueshmërinë e produkteve shqiptare dhe për të frymëzuar biznese të tjera drejt eksportit.

Pjesëmarrja në panairë ndërkombëtare:

- BIOFACH 2025 (Gjermani) – produktet organike
- Wine Paris 2025 (Francë) – verërat autoktone
- Expo Food Athinë, Riga Food,
- Nordic Organic Food Fair (Suedi),
- Organic Expo Dubai

Çfarë u komunikua:

- Përgatitja e kompanive para panairëve
- Prezantimi i produkteve shqiptare
- Roli dhe rëndësia e pjesëmarrjes së kompanive shqiptare në stenda ndërkombëtare
- Roli i AIDA-s mbi takimet B2B dhe interesimi i tregjeve të huaja

Marketingu për postim në rrjetet sociale përdori:

- Reels dhe video storytelling për produkte specifike
- Infografikë informuese
- Storytelling për biznese të suksesshme që kanë përfituar nga mbështetja e AIDA-s dhe kanë hyrë në tregje të reja (ETNO ART, FENIX, Enofama)

Në funksion të rritjes së kapaciteteve eksportuese të SME-ve shqiptare, marketingu mbështeti një sërë aktiviteteve informuese, trajnuese dhe promovuese, duke i komunikuar në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme për bizneset.

Trajnimet për eksportuesit, workshop-et tematike, Info Day-t në qytete dhe prezantimi i **Platformës EXPORT ALBANIA** u shoqëruan me materiale informuese, infografikë shpjeguese dhe publikime digjitale që synonin rritjen e ndërgjegjësimit mbi shërbimet e AIDA-s dhe instrumentet mbështetëse në dispozicion të bizneseve. Marketingu u fokusua në komunikimin praktik të përfitimeve konkrete për bizneset, duke e lidhur drejtpërdrejt informacionin me nevojat e tyre për dalje në tregjet ndërkombëtare.

Konsolidimi i partneriteteve ndërkombëtare dhe marrëdhënieve institucionale

Gjatë vitit 2025, AIDA zhvilloi një numër të konsiderueshëm takimesh institucionale, diplomatike dhe biznesi, të cilat kishin si qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik, tërheqjen e investimeve të huaja, mbështetjen e bizneseve shqiptare dhe krijimin e partneriteteve strategjike afatgjata. Marketingu i AIDA-s luajti një rol thelbësor në pasqyrimin dhe komunikimin e këtyre takimeve, duke siguruar transparencë, dukshmëri institucionale dhe përforsim të imazhit të agjencisë si një partner aktiv dhe i besueshëm për investitorët dhe bizneset.

Takime diplomatike dhe institucionale ndërkombëtare

Marketingu pasqyroi dhe promovoi një sërë takimesh të nivelit të lartë me përfaqësues diplomatikë dhe institucione homologe, të cilat shërbyen për forcimin e dialogut dypalësh dhe shumëpalësh në fushën e investimeve dhe zhvillimit ekonomik. Ndër këto takime përfshihen:

- Takimet me ambasadorët e Kazakistanit, Algjerisë, Sllovenisë, Kosovës dhe Vietnamit
- Takimi me ambasadorin e Kirgistanit në Turqi
- Takimet me delegacione zyrtare dhe investitorë nga Italia, Egjipti, Franca, Turqia, Japonia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe
- Takimet me përfaqësues të Ministrisë së Investimeve të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe kompanisë ADQ
- Takimi me International Finance Corporation (IFC) për zhvillimin e parqeve eko-industriale

Marketingu siguroi pasqyrimin e këtyre takimeve përmes publikimeve institucionale, fotove zyrtare dhe përmbajtjeve informative që theksonin objektivat e bashkëpunimit, sektorët prioritarë dhe rolin e AIDA-s në përmirësimin e klimës së investimeve.

Takime me organizata biznesi, dhoma tregtie dhe rrjete profesionale

Një fokus i veçantë iu kushtua komunikimit të takimeve me organizata biznesi dhe struktura mbështetëse, të cilat janë kyçe për zhvillimin e ekosistemit sipërmarrës dhe ndërkombëtarizimin e bizneseve shqiptare. Marketingu pasqyroi takime të rëndësishme me:

- American Chamber of Commerce in Albania
- ABSL Albania
- Enterprise Greece dhe Shoqatën e Profesionistëve të Lirë të Athinës
- Deloitte Germany
- EEN Albania dhe SIPPO Albania
- International Labour Organization (ILO) për programin SCORE
- EIT për inovacionin dhe sipërmarrjen

Përmes këtyre komunikimeve, marketingu theksoi rolin e AIDA-s si nyje lidhëse midis institucioneve, bizneseve dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke promovuar shërbimet dhe programet mbështetëse që ofrohen për SME-të dhe investitorët.

Marrëveshjet me institucione u shoqëruan me materiale grafike të loguara dhe komunikim të koordinuar në të gjitha kanalet.

Takime me investitorë

Marketingu pasqyroi edhe një sërë takimesh të dedikuara me investitorë ekzistues dhe potencialë, të zhvilluara në kuadër të nismave si Investor Support Days dhe vizitave aftercare. Këto takime përfshinë investitorë nga Holanda, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe kompani që operojnë në Shqipëri në sektorë strategjikë.

Marketingu përgatiti postime vizuale si infografe, reels dhe fotoalbume me mesazhe kyçe për çdo takim. Komunikimi i këtyre aktiviteteve nëpërmjet postimeve në rrjete sociale u fokusua në:

- Mbështetjen e vazhdueshme që AIDA ofron për investitorët
- Adresimin e nevojave konkrete të bizneseve
- Forcimin e marrëdhënieve afatgjata dhe besimit institucional
- Theksoi objektivat e bashkëpunimit (investime, projekte të përbashkëta, mbështetje për SME-të)

Zhvillimi i sektorëve strategjikë dhe ekonomisë së bazuar në inovacion

Marketingu mbështeti promovimin e sektorëve strategjikë si ICT/BPO, turizmi, industria kreative dhe inovacioni, përmes pasqyrit të pjesëmarrjes së AIDA-s në evente ndërkombëtare dhe rajonale. Aktivitetet si ITB Berlin, MIPIM Cannes, VivaTech Paris, CxOutsourcers Mynih, ABSL Conference, Tirana SLUSH'D dhe GEW Albania u përdorën për të pozicionuar Shqipërinë si një destinacion në rritje për investime inovative dhe shërbime me vlerë të shtuar.

Marketingu krijoi përmbajtje dinamike dhe vizuale, duke përdorur video, reels dhe grafika, për të komunikuar vizionin e AIDA-s për zhvillimin e këtyre sektorëve dhe për të theksuar rolin e talenteve shqiptare, transformimin digjital dhe qëndrueshmërinë.

Fushatat outreach dhe aftercare në sektorin ICT/BPO u pasqyruan nga marketingu si një element i fortë i mbështetjes institucionale ndaj investitorëve ekzistues.

Në kuadër të këtyre fushatave, marketingu promovoi një seri takimesh dhe vizitash aftercare, ku AIDA zhvilloi dialog të drejtpërdrejtë me kompani të rëndësishme si: TOK Digital, Novus Albania, Hermex, Assist Digital, Concentrix Albania, Communication Progress, Digit Sapiens, Fast Payroll, First, si dhe Kineton Albania në bashkëpunim me ABSL Albania. Këto aktivitete u komunikuan përmes postimeve, fotove dhe videove informuese, duke theksuar qasjen proaktive të AIDA-s ndaj investitorëve dhe angazhimin për përmirësimin e klimës së biznesit.

Promovimi i Artizanatit Shqiptar dhe Industrive Kreative

Eventi ZAN'ART përbën një nga aktivitetet më përfaqësuese të vitit 2025 në drejtim të promovimit të artizanatit shqiptar dhe industrive kreative. Marketingu i AIDA-s luajti një rol kyç në promovimin e këtij eventit, i cili mbledhi mbi 40 artizanë nga e gjithë Shqipëria dhe shërbeu si një platformë për ruajtjen, promovimin dhe modernizimin e trashëgimisë artizanale.

Marketingu mbështeti ZAN'ART përmes:

- Promovimit paraprak të eventit në media dhe rrjete sociale
- Pasqyrit të 4 workshop-eve artizanale
- Komunikimit të tryezës së diskutimit me përfaqësues institucionesh
- Krijimit të përmbajtjes vizuale (foto, video, reels) që theksonte vlerën kulturore, ekonomike dhe kreative të artizanatit shqiptar

Përmes kësaj qasjeje, marketingu kontribuoi në pozicionimin e artizanatit si një sektor me potencial zhvillimi ekonomik, eksporti dhe turizmi kulturor, duke e lidhur atë me objektivat strategjikë të AIDA-s për zhvillim të qëndrueshëm dhe diversifikim të ekonomisë.

Kanale dhe Mjete Komunikimi

Në vitin 2025, përdorimi i kanaleve dhe mjeteve të komunikimit nga marketingu i AIDA-s u orientua nga objektiva të qarta strategjike, të lidhura ngushtë me misionin e agjencisë për promovimin e investimeve, mbështetjen e eksporteve, forcimin e imazhit institucional dhe rritjen e ndërveprimit me bizneset dhe partnerët ndërkombëtarë.

Aktivitetet e marketingut u fokusuan në krijimin e përmbajtjes promovuese, prodhimin e materialeve të loguara dhe videove, komunikimin në rrjetet sociale, bashkëpunimin me median dhe mbulimin e vazhdueshëm të arritjeve institucionale, duke siguruar koherencë vizuale dhe mesazh të unifikuar në të gjitha kanalet e komunikimit.

Bashkëpunimi me Grupin e Medias – Mbështetje për Dukshmëri dhe Pasqyrim Publik

Përveç komunikimit digjital, marketingu i AIDA-s ndërtoi dhe menaxhoi një grup media bashkëpunuese, i cili gjatë vitit 2025 luajti një rol të rëndësishëm në pasqyrimin e aktiviteteve, eventeve, shërbimeve dhe arritjeve institucionale të agjencisë. Ky grup media kontribuoi në transmetimin dhe publikimin e informacionit përmes kanaleve televizive, portaleve online dhe mediave të shkruara, duke zgjeruar ndjeshëm shtrirjen e mesazheve të AIDA-s.

Marketingu koordinoi komunikimin me media të ndryshme, duke siguruar mbulim për eventet kryesore, intervista, kronika informative dhe artikuj tematikë që pasqyronin rolin e AIDA-s në promovimin e investimeve, mbështetjen e eksporteve dhe zhvillimin e sektorëve strategjikë.

Ky bashkëpunim ishte veçanërisht i rëndësishëm për evente të mëdha si Match Maker Albania, forumet ekonomike ndërkombëtare, panairët dhe aktivitetet me delegacione investitorësh.

Mbulimi mediatik u realizua përmes:

- Televizioneve kombëtare: Top News, A2 CNN, Vizion Plus, Ora News, RTSH, MCN TV, etj.
- Mediave online dhe ekonomike: Koha Jonë, ATA, Business Magazine, Ekofin.al, Revista Monitor, Telegraf etj.

Materiale Printime dhe Digjitale

Marketingu ishte përgjegjës për përgatitjen dhe përdorimin e materialeve promociionale në funksion të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Këto materiale përfshinë:

- Broshura institucionale dhe sektoriale: "Invest in Albania 2025", "Factsheet: Bujqësia, Agroturizmi & Akuakultura", "Factsheet: ICT & BPO Sector"
- Fletëpalosje informuese dhe materiale të shkurtra për shpërndarje të shpejtë
- Materiale të personalizuar për panairë dhe evente specifike (si broshura dhe kartëvizita për RIGA FOOD, BIOFACH, Wine Paris)
- Udhëzues praktikë si "Soft Landing" për investitorët e rinj
- Materiale të loguara për stafin

Të gjitha materialet u përgatitën në përputhje të plotë me identitetin vizual të AIDA-s dhe u përdorën si mjete mbështetëse për komunikimin institucional dhe promovimin e shërbimeve.

Faqja Zyrtare Web

Faqja zyrtare e AIDA-s u përdor si kanal zyrtar informimi dhe arkivimi të aktiviteteve të vitit 2025.

-Rrjetet Sociale

Prania digjitale e AIDA-s në platformat kryesore sociale pati një rritje të konsiderueshme në angazhim dhe përfshirje. Aktiviteti në Instagram dhe Facebook ishte veçanërisht intensiv dhe i diversifikuar:

- Rritje vjetore në angazhim: +202.1% (sipas të dhënave të analitikës)
- Rritje në përdorues të rinj: +221.0%
- Rritje në ndërveprime (event count): +623.0%

Videot më të suksesshme: ato që promovonin eventet e mëdha (Match Maker Albania, panaiet ndërkombëtare) dhe story-t e suksesit të bizneseve.

Rrjetet sociale përbënin kanalin kryesor të komunikimit ditor të marketingut gjatë vitit 2025. Ato u përdorën për promovimin e aktiviteteve të AIDA-s para, gjatë dhe pas zhvillimit të tyre, duke siguruar vazhdimësi dhe koherencë në komunikim.

Marketingu publikoi në mënyrë të vazhdueshme:

- Postime vizuale të dizajnuara sipas identitetit institucional
- Infografikë informuese
- Video dhe reels promovuese
- Mbulim live gjatë eventeve kryesore
-

-Statistika e përmbajtjes:

- Total postime në Instagram & Facebook: 630 postime
- Prej tyre video & reels: 155 (24.6% e përmbajtjes totale)
- Postime statike (foto, infografikë, tekst): 475
- Postimet mesatare në javë: 12 postime

TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË AIDA

Misioni i Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse:

Qëllimi kryesor i Drejtorisë të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është mbështetja e veprimtarisë së Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin normal të proceseve të punës, si dhe të ndjekë të gjithë aktivitetin ekonomik - financiar dhe administrativ të Agjencisë, konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në përmbushje të misionit Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ka në përbërje të saj personelin e nevojshëm të detajuar sipas pozicioneve sa më poshtë:

Drejtor i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 1(një)

Sektori i Financës i përbërë nga :

- Specialist Finanace 3 (tre)

Aktualisht 1 pozicion pune në këtë sektor është vakant.

Sektori i Burimeve Njerëzore, i përbërë nga:

- Shef sektori 1(një)
- Specialist i Burimeve Njerëzore 1(një)
- Specialist Jurist 1(një)
- Specialist protokoll/arkiv 1 (një)
- Punonjës Informacioni 1(një)
- Shoferë 2 (dy)
- Magazinier 1(një)
- Punonjës Pastrimi 1(një)

Aktualisht pozicioni i punës magazinier është vakant.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Struktura organizative e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), është miratuar me Vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 1, datë 08.11.2024 (nr.1749 prot., datë 08.11.2024) “Për disa ndryshime në vendimin nr. 3, datë 17.06.2019 të Bordit Drejtues “Për miratimin e niveleve të pagave dhe të organikës të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)” është miratuar struktura e re e AIDA-s.

Struktura e re ka riorganizuar përbërjet e drejtorive, konkretisht është shkruar Drejtoria e Koordinimit dhe është krijuar Drejtoria e Investimeve Strategjike. Ndërkohë ka patur shtim të numrit të specialistëve në përbërjen e disa strukturave dhe shtim të sektorëve, konkretisht sektori i after care nga një sektor është kthyer në drejtori me një sektor të shtuar në kuadër të procesit të kërkimit dhe zhvillimit si detyrë tashmë e ngarkuar mbi këtë njësi.

Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse nga një strukturë horizontale është ndryshuar duke e ndarë me dy sektor përbërjen e saj, konkretisht riformatimi përfshinë identifikimin e sektorit të financës të ndarë nga sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, duke shtuar përgjegjës sektori për burimet njerëzore dhe shërbimet. Gjithashtu stafi mbështetës i nevojshëm i cili mungonte si nëpunës informacioni dhe nëpunës magazine është përfshirë në përbërjen e këtij sektori.

Gjatë vitit 2025, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 1, datë 25.03.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr.2, datë 04.01.2011 “Për miratimin e statutit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, janë realizuar procedurat e nevojshme për rekrutimin e stafit për plotësimin e pozicioneve të punës që kanë rezultuar vakant.

Gjatë këtij viti janë rekrutuar 11 (njëmbëdhjetë) punonjës të rinj dhe janë larguar 5 (pesë) punonjës më kërkesën e tyre (dorëhëqje);

Theksojmë se edhe gjatë këtij viti, AIDA, nuk ka punësuar student ekselence në kuadër të nismës “Gati për Shqipëri” dhe nuk ka patur punonjës me kontratë jashtë organikës.

Gjatë vitit 2025, punonjësit e AIDA-s kanë rritur kapacitetet dhe aftësitë duke marrë pjesë në trajnime me tematika si më poshtë:

- “Programi i Diplomacisë Ekonomike” Clingendael Institute
- “Auditimi i fondeve të BE-së sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare”, AKSHI
- “Trajnim për digjitalizimin e dokumenteve të institucioneve në varesi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë

Në fund të vitit, u bë dhe identifikimi i fushave të cilësuar si prioritare për trajnim nga stafi i cili u përcoll tek ASPA dhe INSTAT.

Burimet e financimit dhe masa e fondeve të alokuara gjatë vitit 2025

Bazuar në ligjin nr.10303, datë 15.07.2010“Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve(AIDA)”, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit;
- Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në përmbushje të misionit të saj, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, ka administruar dhe menaxhuar fonde nga 2(dy) burime financimi, përkatësisht nga:

A.Buxheti i Shtetit, janë akorduar fonde në fillim të vitit 2025, në masën **264,221,000 lekë**, të detajuara sa më poshtë:

- a. 227,221,000 lekë, fonde të akorduara në grupin e shpenzimeve korente,
- b. 37,000,000 lekë, fonde të akorduara në grupin e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm.

Fondet buxhetore të akorduar për vitin 2025 gjatë periudhës raportuese janë miratuar dhe kanë pësuar këto ndryshime (shtesa / pakësime):

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 16474/3 prot., datë 31.01.2025 “Dërgohet shkresa nr. 17786/17, datë 21.01.2025 “Detajimi i shpenzimeve korrente për vitet 2025-2027”, protokolluar me tonën nr. 218, datë 04.02.2025; miratimi i buxhetit fillestar për shpenzime korente 227,221,000 lekë;

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 2775/7 prot., datë 25.02.2025, protokolluar me tonën nr. 351/4, datë 25.02.2025, “Miratim transferim fondi shpenzime korrente, program 04130”, është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 602 0000 në masën 13,000,000 lekë;

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 3211/2 prot., datë 04.03.2025 “Dërgohet shkresa nr. 1110/1, datë 25.02.2025 “Detajimi i shpenzimeve kapitale për vitet 2025-2027”, protokolluar me tonën nr. 856, datë 06.03.2025; miratimi i buxhetit fillestar për shpenzime kapitale në masën 37,000,000 lekë;

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) me nr.3211/5 prot., datë 28.03.2025, protokolluar me tonën nr. 987, datë 01.04.2025 është miratuar saktësimi i kapitullit për projektin “TVSH për projektet me financim të huaj”, nga kapitulli 01 në kapitullin 04.

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) me nr. 2503/3 prot., datë 28.03.2025, protokolluar këtu me nr. 997, datë 03.04.2025, “Mbi miratimin e detajimit të planit për fondin e veçantë” është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 606 0000 në masën 80,000 lekë.

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 2773/3 prot., datë 08.04.2025, miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit të investimit duke e pakësuar fonde në masën 1,170,000 lekë në projektin “Përmirësime të sistemeve”, dhe shtuar projektin e ri “Blerje pajisje zyre AIDA”, në masën 1,170,000 lekë.

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 5463/4 prot., datë 03.06.2025 “Dërgohet shkresa nr.7329/1, datë 20.05.2025 “Transferim fondi për shpenzime kapitale”” është miratuar shtesa e fondeve në llogarinë ekonomike 231, “Fond i Konkurrueshmërisë” në masën 873,333 lekë dhe pakësimi i fondeve në llogarinë ekonomike 231, “Mbështetje e Biznesit Kreativ”, në masën 873,333lekë.

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.7582 prot., datë 05.06.2025, protokolluar me tonën nr. 1188/2, datë 10.06.2025, “Miratim transferim fondi shpenzime korrente, program 04130”, është shtuar fondi në llogarinë ekonomike 602 0000 në masën 10,000,000 lekë;

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, dhe Inovacionit nr.814/8 prot., datë 11.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2124, datë 15.12.2025, “Dërgohet shkresa nr.14505/135 “Miratim pjesor i ndryshimit të buxhetit për vitin 2025”, në zbatim të Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025””, janë shtuar fondet buxhetore në kodin e ministrisë së linjës 04, në grupin e shpenzimeve korente artikulli 600 në masën 18,379,012 lekë dhe artikulli 601 në masën 1,111,519 lekë, duke pakësuar fondet në kodin e ministrisë së linjës 12, në të njëjtin artikull dhe në të njëjtën masë (Bazuar në vendimin nr. 516, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”, u ndryshua kodit i ministrisë së linjës për AIDA, ishte 12 dhe bëhet 04);

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, dhe Inovacionit nr.814/9 prot., datë 17.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2157, datë 22.12.2025, “Dërgohet shkresa nr.14505/166 datë 04.12.2025, “Në zbatim të Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025”, janë në kodin e ministrisë së linjës 04, në grupin e shpenzimeve kapitale artikulli 231 në masën 8,526,757 lekë, duke pakësuar fondet në kodin e ministrisë së linjës 12, në artikullin 231 dhe në të njëjtën masë (Bazuar në vendimin nr. 516, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”, u ndryshua kodit i ministrisë së linjës për AIDA, ishte 12 dhe bëhet 04);

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, dhe Inovacionit nr.2839/4 prot., datë 09.01.2026, protokolluar me tonën nr. 76, datë 20.01.2026, “Dërgohet shkresa nr.18059/76, datë 19.12.2025, “Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025”, janë pakësuar fonde në grupin e shpenzimeve kapitale artikulli 231, “TVSH për projekte me financim të huaj” në masën 1,300,000 lekë; e cila lidhet me fondin që përdoret për financimet e huaja ku TVSH rimburohet nga shteti në rast se gjatë zbatimit të aktiviteve gjenerohen shpenzime me këtë përmbajtje;

-Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, dhe Inovacionit nr.2839/6 prot., datë 20.01.2026, protokolluar me tonën nr. 137, datë 22.01.2026, “Dërgohet shkresa nr.18550, datë 31.12.2025, “Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025, për shpenzime korente”, janë pakësuar fonde në grupin e shpenzimeve korente artikulli 600, në masën 13.317,573 lekë; dhe fonde në grupin e shpenzimeve korente artikulli 601, “në masën 281,597 lekë;

B.Financim i huaj, referuar shkresës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.3771/3 prot., datë 28.03.2025 (protokolluar me tonën nr. 991, datë 02.04.2025) “Dërgohet shkresa me nr.4375/1 prot, datë 18.03.2025 “Detajimi pjesor i buxhetit 2025-2027 për shpenzime kapitale”, miratuar në masën **5,300,000 lekë** si plan për shpenzime me financim të huaj.

-Projekti “Skills for Jobs Albania Montenegro”, në masën 1,300,000 lekë;

-Projekti “EEN Albania” në masën 4,000,000 lekë,

Gjatë vitit ushtrimor 2025 nga donatori janë transferuar fonde në masën 7,727,304.3 lekë, ndërkohë për mbajtjen e aktiviteteve referuar projekteve janë shpenzuar 4,871,836 lekë.


Në përfundim të vitit 2025, rezulton se fondi i rishikuar për AIDA-n është në total në masën **275,701,830 lekë**. (270,401,830 lekë financim nga Buxheti Shtetit dhe 5,300,000 lekë Financim i Huaj).

Zbatimi i buxhetit për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, fondet e AIDA-s të akorduara nga Buxheti i Shtetit, të detajuara në grupin e shpenzimeve korrente të detajuara në artikujt 600, 601, 602, 604, 606 dhe grupin e shpenzimeve kapitale të detajuara në artikullin 231, janë shpenzuar në funksion të përmbushjes së objektivave të institucionit e paraqitur, masa e realizimit të fondeve paraqitet si më poshtë:

Fondi për paga (artikulli 600) dhe sigurime (artikulli 601) u realizuan përkatësisht në masën 100%. Për sa i përket shpenzimeve korrente, ato u realizuan në masën 94%. Shpenzimet për transferta individësh u realizuan në masën 31% dhe shpenzimet për mbështetje me grante në masën 98%. Ndërkohë këtë vit, ndryshe nga viti i kaluar, AIDA pati realizim të kënaqshëm lidhur me fondet e përcaktuara për investime, të cilat u realizuan në masën 97%.

Më poshtë po ju paraqesim në formë grafike rezultatet e realizimit të buxhetit për vitin 2025



Dokumenta ligjore prodhuar gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, DFBNJSHM, në kuadër të përmirësimit të akteve rregulluese për proceset e punës në AIDA, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, ka punuar për hartimin dhe finalizimin e disa dokumentave si:

-Regjistri i riskut për AIDA-n

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv është ngritur Ekipi për Menaxhimin e Riskut i përbërë nga drejtuesit e njësive të AIDA-s, të cilët punuan për hartimin e regjistrit të riskut në realizimin e objektivave të AIDA-s para dhe pas kontrollit.

-Rregulloren e brendshme të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve

Bazuar në ligjin nr.10303, datë 15.07.2010 “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve(AIDA)”, u hartua materiali i nevojshëm për hartimin e rregullores së brendshme të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve miratuar me Vendimi nr.1, datë 29.04.2025, të Bordit Drejtues “Për miratimin e rregullores së brendshme të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”

PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM

Programi i Transperencës përfshin të dhënat mbi strukturën organizative, funksionet, procedurat e vendimmarrjes, si dhe legjislacionin që rregullon veprimtarinë e institucionit. Ai është i përditësuar dhe i aksesueshëm në një rubrikë të dedikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDA. Për më shumë informacion mund të konsultohet link <https://aida.gov.al/aida/programi-i-transparences/>

Për sa i takon, të drejtës për informim, rezulton se gjatë vitit 2025, dinamika e kërkesave për informim paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	Sasia
Kërkesa të pranuar gjithsej	19
Kërkesa të trajtuara me përgjigje të plotë	18
Kërkesa të refuzuara	0
Kërkesa të pjesshme	0
Kërkesa të deleguara në institucione të tjera	1
Koha mesatare e kthimit të përgjigjes	5 ditë pune

AIDA ka përditësuar rregullisht Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve. Ky regjistër publikohet çdo muaj në faqen zyrtare të internetit të insitucionit dhe përmban datën e kërkesës, objektin e kërkesës dhe statusin dhe datën e përgjigjes. Gjatë këtij viti për insitucionin tonë nuk ka patur ankesa nga subjektet pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe nuk ka patur as vendime apo rekomandime nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Për më shumë informacion mund të konsultohet link:

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2026/02/00.-REGJISTRI-AIDA-2025_30112025.pdf